FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 196

Tiranë – E hënë, 20 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 17.12.2021	Për shkarkimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve	18557
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 290, datë 14.12.2021	Për delegimin e kompetencave	18557
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 622, datë 13.12.2021	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve të llojit derra, në bazën e të dhënave kombëtare	18557
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 4.11.2021	Me objekt konstatimin antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar më 30 qershor 2019, për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe, si rrjedhojë, konstatimin antikushtetues të zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve. Verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së Partisë Bindja Demokratike, në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30 qershor 2019	18559
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 221, datë 9.11.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin tetor 2021	18578
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 222, datë 9.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2021	18579
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 223, datë 9.11.2021	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018, mbi licencimin e shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. (FTL sh.a.), në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	18581

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 9.11.2021	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri më datë 27.10.2044.....	18582
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 225, datë 9.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë *(United Bank of Albania)* sh.a.....	18583
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 9.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albesp Trading & Consulting" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	18584
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 9.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Albesp Trading & Consulting" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	18586
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 235, datë 26.11.2021	Mbi miratimin e rregullores "Për procedurat dhe afatet, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve".....	18587
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 429, datë 11.11.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a.....	18594
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 430, datë 11.11.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a.....	18595
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 431, datë 11.11.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.....	18596
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 432, datë 11.11.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a.....	18597

VENDIM
Nr. 795, datë 17.12.2021

PËR SHKARKIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"; dhe të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 127, datë 3.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Agim Ismaili, drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, shkarkohet nga kjo detyrë.
2. Z. Admir Abrija emërohet drejtor i përgjithshëm i Burgjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

URDHËR
Nr. 290, datë 14.12.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore"; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2021.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
4. Urdhri i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 5.1.2021, "Për delegimin e kompetencave", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 622, datë 13.12.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR REGJISTRIMIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, NË BAZËN E TË DHËNAVE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës; pika 1 e nenit 6, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Për qëllim të këtij urdhri, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "mjete transporti" janë automjetet rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore;

b) "numër unik i regjistrimit" është një numër i caktuar nga autoriteti kompetent të një stabilimenti të regjistruar;

c) "kodi identifikues i kafshës" është kodi individual që shfaqet në mjetet e identifikimit të aplikuara për një kafshë, dhe përfshin:

i. kodin e shtetit ku mjetet e identifikimit janë aplikuar tek kafsha;

ii. e ndjekur nga numri individual identifikues numerik i caktuar për kafshën me jo më shumë se 12 shifra;

ç) "kafshë e llojit derr" është një kafshë e llojit thundrak të familjes *suidae*;

d) "identifikues elektronik" nënkupton një shënjues me identifikim radiofrekuence (RFID);

dh) "baza e të dhënave kompjuterike" nënkupton një bazë të dhënash kompjuterike të kafshëve dhe fermave blegtorale, RUDA;

e) "zinxhiri i prodhimit" nënkupton zinxhirin e prodhimit të integruar të një statusi të përbashkët shëndetësor. në lidhje me sëmundjet e listuara, që konsistojnë në një kuadër bashkëpunues të institucioneve të specializuara të miratuara nga SPV-ja, për qëllimin e pikës 5, midis të cilëve kafshët e llojit derr lëvizen për të përfunduar ciklin e prodhimit.

2. Operatorët e stabilimenteve, që mbajnë kafshë të llojit derr, duhet të sigurojnë që secila nga kafshët e llojit derr, të identifikohet me mjetet e mëposhtme të identifikimit:

a) një matrikull konvencional në vesh ose një matrikull elektronik në vesh, i vendosur në pjesën e jashtme të veshit të kafshës, me një pamje të dukshme, të lexueshme dhe të pandryshueshme të numrit unik të regjistrimit, të:

i. stabilimentit të lindjes së kafshës; ose

ii. stabilimentit të fundit të zinxhirit të prodhimit të përmendur në pikën 5 të këtij urdhri, në rastin kur këto kafshë zhvendosen në një stabiliment jashtë zinxhirit të prodhimit; ose

b) një tatuazh, i aplikuar në kafshë në mënyrë të përhershme të numrit unik të regjistrimit, të:

i. stabilimentit të lindjes së kafshëve; ose

ii. stabilimentit të fundit të zinxhirit të prodhimit të përmendur në pikën 5 të këtij urdhri, kur këto kafshë lëvizin në një stabiliment jashtë zinxhirit të prodhimit.

3. Operatorët e stabilimenteve që mbajnë kafshë të llojit derr të sigurojnë, që:

a) mjetet e identifikimit aplikohen për kafshët e llojit derr, në:

i. stabilimentin e lindjes; ose

ii. stabilimentin e fundit të zinxhirit të prodhimit të përmendur në pikën 5, kur këto kafshë lëvizin në një stabiliment jashtë këtij zinxhiri të prodhimit;

b) asnjë mjet identifikimi nuk hiqet, modifikohet ose zëvendësohet pa dijeninë e autoritetit kompetent.

4. Operatorët e stabilimenteve, që mbajnë kafshë të llojit derr, mund të zëvendësojnë mjetet e identifikimit të përmendura në pikën 2, me një identifikues elektronik të miratuar nga SPV-ja.

5. Në përjashtim nga pika 1 deri në pikën 4 të këtij urdhri, autoriteti kompetent mund të lejojë operatorët e stabilimenteve të zinxhirit të prodhimit të devijojnë nga detyrimi për të identifikuar kafshët e llojit derr, kur këto kafshë synohen të lëvizin brenda këtij zinxhiri prodhues, me kusht që zbatimi praktik i masave të gjurmueshmërisë të sigurojë gjurmueshmërinë e plotë të këtyre kafshëve.

6. Autoriteti kompetent mund të përjashtojë operatorët e stabilimenteve të mbyllura dhe operatorët që mbajnë kafshë të llojit derr për qëllime kulturore, shfaqjeje ose shkencore nga kërkesat e identifikimit për kafshët e llojit derr të parashikuara në pikën 2.

7. Gjatë dhënies së përjashtimeve të parashikuara në pikën 6 të këtij urdhri, SPV-ja do të sigurojë që një transponder i injektueshëm është autorizuar prej tij për të identifikuar kafshët e llojit derr të referuara në pikën 6 të këtij urdhri dhe që mjete të tilla identifikimi të autorizuara, përputhen me kërkesat e pikës 8 të këtij urdhri.

8. SPV-ja të hartojë procedura për aplikim për operatorët kur ata kërkojnë një përjashtim të tillë, siç parashikohet në pikën 6 të këtij urdhri.

9. Autoriteti kompetent duhet të sigurojë që mjetet e identifikimit, si: matrikull konvencional të veshit, matrikuj elektronik të veshit, transponderat e injektueshëm dhe tatuazhe, të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) ato pasqyrojnë, ose:

i. numrin unik të stabilimentit të lindjes së kafshës; ose

ii. numrin unik të regjistrimit të stabilimentit të fundit të një zinxhiri prodhues, në rastin e kafshëve që do të lëvizin nga stabilimenti i një zinxhiri furnizues në një stabiliment tjetër jashtë këtij zinxhiri prodhues;

b) ato janë miratuar nga SPV-ja.

10. SPV-ja vendos procedura për aplikim, për:

a) prodhuesit për miratimin e mjeteve të identifikimit për kafshët e llojit derr që mbahen në territorin e tyre;

b) operatorët për mjetet e identifikimit të kafshëve të llojit derr që do të vendosen në stabilimentin e tyre.

11. Informacioni i ruajtur në bazën e të dhënave kompjuterike të jetë në përputhje me rregullat e mëposhtme:

a) informacioni i mëposhtëm duhet të regjistrohet për stabilimentet që mbajnë këto kafshë:

i. numri unik i regjistrimit;

ii. emri dhe adresa e operatorit të stabilimentit;

b) informacioni i mëposhtëm duhet të regjistrohet për çdo lëvizje të këtyre kafshëve për në stabiliment dhe nga stabilimenti:

i. numrin e përgjithshëm të kafshëve;

ii. numrin unik të regjistrimit të stabilimentit të tyre të origjinës dhe të destinacionit;

iii. datën e mbërritjes;

iv. datën e nisjes.

12. Dokumenti i lëvizjes brenda territorit të vendit duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) informacionin e mbajtur në bazën e të dhënave kompjuterike, sipas pikës 11, shkronja "a", paragrafi "i", dhe shkronja "b", paragrafët "i", "ii" dhe "iv";

b) numrin unik të regjistrimit të transportuesit;

c) numrin e targës ose numrin e regjistrimit të mjeteve të transportit.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2023.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

VENDIM
Nr. 36, datë 4.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 23.6.2021 dhe 2.11.2021, mori në shqyrtim, në seancë plenare publike çështjen nr. 7 (S) 2019 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, përfaqësuar nga av. Jordan Daci, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Bledar Dervishaj dhe Katrin Treska, me autorizim,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi, me autorizim,

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Elira Kokona dhe avokati i shtetit Embro Ahmetaj, me autorizim,

Avokati i Popullit, Erinda Ballanca, e paraqitur personalisht në gjykim,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Madalena Koja, me autorizim,

Partia "Bindja Demokratike", përfaqësuar nga av. Erind Mërkuri dhe Fabian Topollari, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi antikushtetues i zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar më 30 qershor 2019, për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe, si rrjedhojë, konstatimi antikushtetues i zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve.

Verifikimi i kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike", në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 13, 15, 16, 17, 18, 22, 42, 43, 45, 48, 65, 92, 93, 109,

116, 122, 131, pika 1, shkronjat: "d", "e" dhe "f", 134, pika 1, shkronja "h", dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, 10 dhe 17, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 3 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës (*Presidenti*), i cili kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave dhe partisë "Bindja Demokratike", të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*KQZ*), i cili e la në vlerësim të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykatës*), mendimin e Avokatit të Popullit, opinionin *amicus curia* të Komisionit të Venecies, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me dekretin nr. 10928, datë 5.11.2018, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore" (*dekreti nr. 10928/2018*), Presidenti ka caktuar datën 30.6.2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Dekreti është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 6.11.2018.

2. Presidenti, me dekretin nr. 11199, datë 10.6.2019, "Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018, të Presidentit të Republikës 'Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"' (*dekreti nr. 11199/2019*), ka shfuqizuar datën 30.6.2019, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, duke marrë në konsideratë situatën aktuale në vend dhe duke vlerësuar se kjo vendimmarrje është mbështetur në argumente kushtetuese e ligjore dhe synon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parimeve kushtetuese të demokracisë dhe pluralizmit politik, si dhe të angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë. Në vlerësimin e Presidentit, ky akt synonte ndërprerjen e një procesi zgjedhor fiktiv, i transformuar në një proces votimi pa garë dhe pa alternativa, në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

3. Në datën 13.6.2019, Kuvendi ka miratuar Rezolutën "Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018, 'Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"', me të cilën e ka konsideruar dekretin si një akt absolutisht të pavlefshëm, që bie në kundërshtim flagrant me Kushtetutën dhe ligjin. Kuvendi u bën thirrje të gjitha organeve publike, që ngarkohen nga ligji me detyra në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të qershorit 2019, të konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit të datës 10.6.2019, për shfuqizimin e dekretit nr. 10928/2018 dhe të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës, për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor.

4. Me kërkesën e datës 13.6.2019, partia "Uniteti Kombëtar", e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.6.2019 me vendimin nr. 37, datë 11.3.2019, të KQZ-së, i ka kërkuar kësaj të fundit çregjistrimin nga procesi zgjedhor, si dhe heqjen e emrit të saj nga fleta e votimit. Me vendimin nr. 836, datë 13.6.2019, KQZ-ja ka vendosur rrëzimin e kërkesës së partisë "Uniteti Kombëtar, duke vlerësuar se: "*...i vetëdijshëm se nuk është ai organi publik që mund të shfuqizojë një akt administrativ të një organi tjetër publik, në pozitën e "organit që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative" (ankimin administrativ) sipas pikës 2, të nenit 110, të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) "ka detyrimin ligjor të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ" dekretit nr. 11199, datë 10.6.2019, të Presidentit të Republikës (sipas detyrimit që parashikon neni 111 i KPA-së). Në mbështetje të parashikimeve të neneve 110 dhe 111, të KPA-së, KQZ-ja, duke qenë organi më i lartë shtetëror i përhershëm i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë, duke u njohur edhe me aktin në fjalë, e konstaton atë si absolutisht të pavlefshëm, nul, sikur nuk ekziston dhe vijon punën për realizimin me sukses të procesit*

zgjedhor për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor të datës 30.6.2019.".

5. Kundër vendimit të lartpërmendur të KQZ-së, partia "Uniteti Kombëtar" ka paraqitur ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili, me vendimin nr. 12, datë 24.6.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se: "*ndërkohë që e gjeti të bazuar vendimmarrjen e KQZ-së, vlerësoi si të pabazuar në ligj padinë e paraqitur nga partia "Uniteti Kombëtar"*.".

6. Me dekretin nr. 11211, datë 27.6.2019, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore" (*dekreti nr. 11211/2019*), Presidenti ka caktuar datën 13.10.2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Dekreti nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare.

7. Partia "Bindja Demokratike" është regjistruar si person juridik në regjistrin e partive politike me vendimin nr. 8, datë 25.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me vendimin nr. 230, datë 27.4.2019, të KQZ-së është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

8. Në datën 30.6.2019, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Misioni vëzhgues i ODIHR-it, në raportin përfundimtar për vëzhgimin e zgjedhjeve vendore të datës 30.6.2019, ka konstatuar se: "*opozita vendosi të mos marrë pjesë, kurse qeveria u tregua e vendosur për t'i mbajtur zgjedhjet pa opozitën*", si dhe "*zgjedhjet u mbajtën në një situatë krize politike dhe institucionale, që vinte nga një antagonizëm i hershëm mes Partisë Socialiste (PS) qeverisëse dhe Partisë Demokratike (PD) në opozitë... Atmosfera e ngërçit dhe e pasigurisë juridike mes institucioneve kryesore minoi besimin e publikut te legjitimiteti i zgjedhjeve. Në muajin shkurt, në Tiranë, filluan protesta të vazhdueshme të opozitës kundër Kryeministrit, të cilat u shenjuan shpesh nga dhuna dhe vandalizmi i drejtuar kundër institucioneve shtetërore. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, protestuesit në pjesë të tjera të vendit vunë në shënjestër administratën zgjedhore, me përfshirjen shpesh të akteve të frikësimit, dhunës dhe zjarrvënies, si dhe përplasjeve mes Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit. Kuadri ligjor mund të ofronte një bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike, nëse do të zbatohej në mënyrë të paanshme dhe me një vullnet të sinqertë politik.*" (*shih faqen 1 të Raportit*). "*Në këtë proces zgjedhor, këto të drejta* [kupto: mundësitë e barabarta përfaqësimi për partitë parlamentare në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore] *u përdorën nga partitë për manovra politike në kurriz të paanshmërisë së administratës zgjedhore. Mospranimi nga ana e partive opozitare për të propozuar anëtarët e tyre në KQZ dhe KZAZ, bashkë me interpretimin më pas nga KQZ-ja të ligjit se vetëm ato parti parlamentare që marrin pjesë në zgjedhje mund të propozojnë anëtarë, e la administratën zgjedhore të paekuilibruar politikisht.*" (*shih faqen 7 të Raportit*). Po sipas këtij raporti: "*koalicioni i drejtuar nga Partia Socialiste, "Aleanca për Shqipërinë Evropiane", doli me kandidatë në të gjitha 61 bashkitë, në 31 prej të cilave nuk pati kundërshtarë. Për këshillat bashkiakë garuan 2 koalicione, 38 parti politike, duke përfshirë 9 parti që garuan të vetme dhe 11 kandidatë të pavarur.*" (*shih faqen 12 të Raportit*).

9. Me vendimet e datës 11.7.2019, KQZ-ja ka verifikuar dhe ka nxjerrë rezultatin për zonat zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

10. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës, me kërkesën e datës 18.7.2019, sipas objektit të saj. Me vendimin e datës 24.12.2019, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Me plotësimin e kuorumit për funksionimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, kjo e fundit, në mbledhjen e datës 7.4.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

11. Shoqata për Autonomi Vendore i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për pjesëmarrje në gjykim si subjekt i interesuar, me kërkesën e datës 21.6.2021, pasi, sipas saj, ka interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje sepse mbron interesat e 60 kryetarëve të bashkive anëtare, të zgjedhur nga zgjedhjet vendore të zhvilluara në datën 30.6.2019. Gjykata, në seancën plenare të datës 23.6.2021, pasi dëgjoi edhe përfaqësuesit e palëve në proces, dhe bazuar në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 8577/2000, që rregullojnë procedurat e gjykimit kushtetues, vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë paraprake, pasi vlerësoi se nuk është paraqitur në formën dhe kohën e duhur.

12. Këshilli i Ministrave, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake në seancë plenare, kërkoi pezullimin e shqyrtimit të çështjes derisa gjykata e shkallës së parë të shprehet për regjistrimin e vendimit të asamblesë së përgjithshme të shoqatës kërkuese për zgjedhjen e kryetarit të saj, me pretendimin se kryetares së Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, zonjës Voltana Ademi, e cila ka

nënshkruar kërkesën në shqyrtim, i mungon legjitimimi formal. Gjykata konstatoi se me vendimin e datës 8.6.2021, të asamblesë së jashtëzakonshme të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë është vendosur zgjedhja e zotit Pjerin Ndreu kryetar, akte që janë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrim, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 762 akti, datë 16.6.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur kthimin e saj për plotësimin e të metave, duke përcaktuar edhe afatin kohor për këtë qëllim. Ndodhur në këto kushte, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e gjykimit për këtë shkak si të pabazuar.

13. Gjykata, pasi dëgjoi parashtrimet dhe prapësimet e palëve pjesëmarrëse në gjykim, në përfundim të seancës plenare, u tërhoq në dhomën e këshillimit dhe, bazuar në nenin 44/b, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi të pezullojë shqyrtimin e çështjes dhe t'i drejtohet Komisionit të Venecies si organ këshillimor i specializuar për dhënien e një opinioni *amicus curia,* në lidhje me standardet dhe parimet që duhet të merren në konsideratë në çështjen në shqyrtim. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata vlerësoi interesin publik dhe rëndësinë e kësaj çështjeje, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve dhe të të drejtave kushtetuese të përfshira, si dhe rolin e procesit zgjedhor në jetën politike e sociale të vendit e parimet themelore demokratike që duhet të ndjekë dhe respektojë ai. Për këtë qëllim ajo u njohu edhe palëve në gjykim të drejtën për të propozuar pyetje, duke përcaktuar afatin për paraqitjen e tyre.

14. Gjykata, pasi vlerësoi edhe pyetjet e paraqitura nga palët, me shkresën nr. 291 prot., datë 9.7.2021, i dërgoi Komisionit të Venecies kërkesën për dhënien e një opinioni *amicus curiae*, duke parashtruar pyetjet që ajo çmoi se kishin rëndësi për disa nga aspektet kryesore të këtij gjykimi, si më poshtë:

14.1 Pyetja nr. 1: A mund të interpretohet neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës se Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të vendosur për kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor?

14.2 Pyetja nr. 2: Duke qenë se parimi i periodicitetit të zhvillimit të zgjedhjeve vendore dhe ai i pluralizmit politik janë parashikuar si parime themelore kushtetuese, cili do të ishte raporti mes tyre në një situatë ku rrezikohet cenimi i secilit parim? Cili parim do të prevalonte mbi tjetrin?

14.3 Pyetja nr. 3: Në një situatë të një klime pasigurie juridike, a ka cenuar sjellja e autoriteteve publike dhe e partive politike të drejtën e votuesve për të pasur mundësi kuptimplotë zgjedhjeje? A duhej ata të siguronin interesin më të lartë të votuesve?

15. Në datën 18.10.2021, Komisioni i Venecies i ka dërguar Gjykatës, në rrugë elektronike, opinionin *amicus curiae* "Mbi kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për vlefshmërinë e zgjedhjeve vendore të zhvilluara në datën 30 qershor 2019" (në gjuhën angleze dhe franceze), i miratuar në Sesionin e 128-të të tij, datë 15–16 tetor 2021 (Dokumenti CDL-AD(2021)026), i cili përmbante përgjigjet e pyetjeve të parashtruara prej saj.

16. Gjykata, në mbështetje të nenit 44/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, e mbledhur menjëherë në datën 19.10.2021, konstatoi rënien e shkakut të masës së pezullimit të kësaj çështjeje dhe vendosi rihapjen e seancës plenare, si dhe njoftimin e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues për datën dhe orën e zhvillimit të saj. Bashkëlidhur njoftimit, palëve në gjykim u është dërguar një kopje e opinionit zyrtar *amicus curia* dhe në vijim, pas përkthimit nga Gjykata, edhe një kopje e tij në gjuhën shqipe.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. Kërkuesja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se zhvillimi i procesit zgjedhor në datën 30.6.2019, ka cenuar:

17.1 *Parimin e shtetit të së drejtës,* për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve në kundërshtim me dekretin e dytë të Presidentit, i cili ka caktuar datën e mbajtjes së zgjedhjeve dhe rrjedhimisht përbën bazën urdhëruese për KQZ-në për të filluar përgatitjet, si dhe shënon edhe lindjen e të drejtave dhe detyrimeve të tjera për subjektet politike dhe zgjedhësit, duke përfshirë edhe kompetencën materiale të Kolegjit Zgjedhor. Ky parim cenohet në këto drejtime:

17.1.1 Parimi i sovranitetit të popullit, i sanksionuar në nenin 2 të Kushtetutës, i lidhur me nenet 1, 3, 4 dhe 45, të Kushtetutës, i cili kërkon që përfaqësuesit të zgjidhen nëpërmjet zgjedhjeve të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike;

17.1.2 Zgjedhjet janë zhvilluar pa pasur një dekret të Presidentit dhe pa u zbatuar aktet e këtij organi nga ana e KQZ-së. Kushtetuta, në nenin 92, shkronja "gj" të saj, parashikon se Presidenti cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, organet e pushtetit vendor dhe referendumet. Ndërkohë që neni 93 i Kushtetutës përcakton se Presidenti, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete. Nisur nga parimet e përgjithshme kushtetuese (nenet 1–14 të Kushtetutës), Presidenti gëzonte legjitimitet në zhdekretimin e datës 30.6.2019, pasi mbajtja e zgjedhjeve në atë situatë minonte parimet themelore të shtetit;

17.1.3 Në kuptim të parimit të epërsisë së Kushtetutës dhe zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të dispozitave të saj, si dhe atij të hierarkisë së akteve ligjore, kompetenca që Kushtetuta i ka njohur Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve ushtrohet drejtpërdrejt dhe nuk ka asnjë kufizim, përveç atij të parashikuar në nenin 65 të Kushtetutës. Nxjerrja e një dekreti që revokon një dekret të mëparshëm është vazhdimësi logjike e pushtetit diskrecionar për caktimin e zgjedhjeve, pasi kjo kompetencë nuk i është dhënë një organi tjetër;

17.1.4 Natyra e akteve të Presidentit përcaktohet së pari nga burimi, që janë drejtpërdrejt normat kushtetuese, pra vetë natyra e normës që autorizon nxjerrjen e aktit. Duke qenë se kemi të bëjmë me akte që janë shprehje e drejtimit politik, që rregullojnë marrëdhënie të përgjithshme për të gjithë territorin e Republikës, këto dekrete mund të vlerësohen vetëm në aspektin e kushtetutshmërisë, ndaj përjashtohet çdo mundësi për vlerësimin e ligjshmërisë së tyre në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor. Edhe nëse ky akt do të ishte administrativ, ai nuk ishte i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të KPA-së, pasi kompetenca nuk ka të meta të dukshme dhe serioze. KQZ-ja nuk mund të konstatonte pavlefshmërinë absolute të tij, në përputhje me nenin 110 të KPA-së, pasi nuk është as organi që e ka nxjerrë, as organi epror i Presidentit dhe as organi kompetent për ta shqyrtuar atë;

17.1.5 Vetëm Presidenti ka të drejtë të ndryshojë datën e zgjedhjeve dhe ky akt është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga kushdo, derisa fuqia e tij të përfundojë me vendim të Gjykatës Kushtetuese ose të Presidentit, ose të humbasë vetvetiu si pasojë e përmbushjes së qëllimit. Duke marrë atribute që i takojnë vetëm Gjykatës Kushtetuese, KQZ-ja ka shkelur edhe parimin e ndarjes së pushteteve.

17.2 Nenin 45 të Kushtetutës, nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në lidhje me nenet 1 dhe 10, të Konventës, pasi zgjedhjet e datës 30.6.2019, nuk kanë garantuar pluralizmin politik dhe pluralizmin e mundësive të zgjedhjes. Vota e hedhur në këto zgjedhje nuk ka pasur asnjë mundësi të ndikonte në zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe anëtarëve të këshillit, pasi, pavarësisht numrit të votave, kandidati i vetëm do të fitonte qoftë edhe me votën e tij. Këto zgjedhje shkelën fshehtësinë e votës, pasi çdo pjesëmarrës në votim, nëse do të vendoste të ushtronte të drejtën e tij të votës, ajo do të ishte e deklaruar me pjesëmarrjen në votim. E njëjta situatë ka qenë edhe në rastet kur ka pasur një kandidat të dytë, për shkak të regjistrimit të partisë "Bindja Demokratike" në kundërshtim me Kushtetutën.

17.3 Parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, të parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, për shkak të mandateve që kanë rezultuar nga zgjedhje monokratike, duke mos u vërtetuar as nevoja për kufizim të garancive kushtetuese dhe as që kufizimi është bërë në përputhje me qëllimin dhe nevojën, si dhe në përpjesëtim me të drejtën që i nënshtrohet kufizimit.

17.4 Partia "Bindja Demokratike" është regjistruar 17 ditë pas mbarimit të afatit ligjor. KQZ-ja e ka regjistruar si subjekt më 27.4.2019, ndonëse ajo ishte regjistruar si parti politike vetëm më 25.4.2019, me një vendim gjyqësor që ka marrë formë të prerë më 10.5.2019. Përveç kësaj, KQZ-ja nuk i ka kërkuar këtij subjekti të mblidhte firma mbështetëse për regjistrimin e tij. Vendimi i KQZ-së është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm dhe veprimtaria politike e partisë "Bindja Demokratike" në zgjedhje është në kundërshtim me Kushtetutën. Për rrjedhojë, edhe fletët e votimit ku pasqyrohet kjo parti dhe kandidatët e saj janë të pavlefshme dhe të paligjshme, pra edhe rezultati në tërësi i zgjedhjeve të datës 30.6.2019.

18. Subjekti i interesuar, Presidenti, duke mbështetur argumentet dhe shkaqet e paraqitura në kërkesë nga kërkuesja, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa vijon:

18.1 Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare përcaktojnë se zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë mekanizmi kushtetues që bën të mundur funksionalitetin e demokracisë. Presidenti, gjatë

ushtrimit të funksioneve të tij, mbikëqyr funksionimin e këtij mekanizmi kushtetues dhe mund të ndërhyjë, brenda caqeve kushtetuese, kur konstaton se po cenohen rregullat që e disiplinojnë këtë mekanizëm për të siguruar respektimin në formë dhe përmbajtje të Kushtetutës, të parimeve dhe të drejtave themelore të parashikuara prej saj, si dhe ruajtjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet organeve të ndryshme shtetërore në shërbim të një interesi të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar.

18.2 Presidenti monitoroi procesin e organizimit zgjedhor pas nxjerrjes së dekretit nr. 10928/2018, nga ku rezultoi se ky proces po konsumonte shkelje të të drejtave dhe lirive themelore dhe parimeve kushtetuese. Gjendja e paligjshmërisë përmes së cilës po kalonte procesi zgjedhor dhe rreziku që e shoqëronte atë mund të parandaloheshin vetëm përmes ndërhyrjes së kreut të shtetit me mjete të parashikuara nga Kushtetuta (dekrete).

18.3 Dekreti i Presidentit për shfuqizimin e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve më 30.6.2019, synonte ndërprerjen e një procesi zgjedhor fiktiv në kundërshtim me parimet demokratike, i transformuar praktikisht në një proces votimi pa garë dhe pa alternativa. Presidenti, pas anulimit të datës së zgjedhjeve, nuk e ndërpreu asnjëherë komunikimin dhe diskutimin me forcat politike edhe për caktimin e një date të re të zgjedhjeve, me qëllim garantimin e së drejtës kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Në përfundim të këtij procesi, me dekretin nr. 11211/2019, Presidenti caktoi datën 13.10.2019 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, me qëllim respektimin e parimit kushtetues të periodicitetit të zgjedhjeve. Kjo ishte e vetmja zgjidhje në kushtet e një krize të rëndë politike, kushtetuese, institucionale dhe të përfaqësimit.

18.4 Procesi i votimeve i zhvilluar në mënyrë të njëanshme në datën 30.6.2019, ishte fiktiv, antikushtetues dhe jo demokratik, që nuk krijoi asnjë pasojë juridike. Realizimi i zgjedhjeve pa pjesëmarrjen e opozitës dhe me një kandidat/alternativë nuk u mundësoi qytetarëve të zgjidhnin midis alternativave konkurruese përfaqësuesit e tyre në nivel vendor. Kjo përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës. Sistemi i qeverisjes vendore, si rezultat i këtyre zgjedhjeve, nuk bazohet në një sistem zgjedhjesh siç parashikojnë nenet 1, pika 3, dhe 109 të Kushtetutës, por në një sistem emërimi të drejtpërdrejtë, i cili ka cenuar strukturën e demokracisë nga poshtë lart dhe pjesëmarrjen e zgjedhësve në qeverisjen vendore.

18.5 Dekretet e Presidentit nuk janë kundërshtuar nga ndonjë forcë politike ose subjekt tjetër politik apo jopolitik përpara ndonjë gjykate, përfshi edhe Kolegjin Zgjedhor, dhe nuk janë ndryshuar, anuluar ose shfuqizuar nga to. Këto akte ishin në fuqi dhe të detyrueshme për zbatim nga të gjithë, përfshirë KQZ-në dhe Kuvendin.

18.6 Regjistrimi si konkurrent i një force tjetër politike, partia "Bindja Demokratike", me vendimin e KQZ-së nr. 230, datë 27.4.2019, është realizuar në kundërshtim me afatet dhe parashikimet e Kodit Zgjedhor.

19. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

19.1 Gjykata nuk ka juridiksion në çështjen konkrete, pasi në zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, nuk përfshihen çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet vendore. Kërkuesja ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së procesit zgjedhor të zhvilluar më 30.6.2019, por nuk ka kundërshtuar ndonjë akt kushtetues ose ligjor për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës. Po ashtu, kërkesa nuk ka lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pushteteve. Gjithashtu, nuk jemi as para situatës së parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Në lidhje me kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe veprimtarinë e tyre, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "d", të Kushtetutës, pretendimet në kërkesë janë të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese.

19.2 Kërkuesja nuk legjitimohet për asnjë nga kërkimet e kërkesës. Në lidhje me kërkimin e parë ajo nuk ka interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje, për sa kohë nuk ka qenë subjekt zgjedhor dhe nuk ka marrë pjesë në zgjedhje. Në lidhje me kërkimin e dytë, kërkuesja nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën, në kuptim të nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

19.3 Për sa i përket themelit të pretendimeve, Kuvendi ka mbështetur qëndrimin e KQZ-së, si

organi përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, i cili nuk e ka vlerësuar të detyrueshëm për zbatim dekretin e Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore, duke arsyetuar se ky akt ishte i pavlefshëm, pasi kishte dalë në kapërcim të kompetencave që Kushtetuta i jep Presidentit.

19.4 Zgjedhjet mund të shtyhen me qëllim legjitimimin e ruajtjes së rendit kushtetues në situata të jashtëzakonshme dhe në këto raste Kushtetuta i ka përcaktuar qartë kompetencat e autoriteteve shtetërore, si dhe kushtet e procedurat përkatëse. Në të tilla raste kompetent për vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme është Kuvendi, me propozim të Këshillit të Ministrave, por një situatë e tillë nuk ka ekzistuar në kohën kur u nxor dekreti nr. 11199/2019 dhe as më pas. Presidenti, në rolin e tij si përfaqësues i unitetit kombëtar, mund të bëjë thirrje publike për qetësi, maturi, vetëpërmbajtje ose dialog për uljen e tensioneve, por nuk ka kompetenca për të vendosur për marrjen e masave të jashtëzakonshme, aq më tepër për shtyrjen e zgjedhjeve.

19.5 E drejta e sovranit për të zgjedhur përfaqësuesit e tij ushtrohet në mënyrë periodike dhe në periudha të caktuara zgjedhore, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Anulimi i zgjedhjeve është një hap që zhvlerëson autoritetin sovran. Data 30.6.2019 ishte data e fundit për caktimin e ditës së zgjedhjeve vendore dhe është brenda afatit që garanton periodicitetin e zgjedhjeve.

19.6 Për zgjedhjet e datës 30.6.2019 ishin regjistruar 48 subjekte politike. Me anulimin e datës së zgjedhjeve u ndërhy në mënyrë joproporcionale në të drejtën për t'u zgjedhur të subjekteve të regjistruara në këto zgjedhje, duke krijuar pabarazi në trajtimin e të drejtave të subjekteve të regjistruara me ato të paregjistruara, pasi u favorizuan këto të fundit.

19.7 Dekreti i Presidentit është një akt nënligjor, për rrjedhojë ai nuk mundet kurrsesi të ketë fuqi mbiligjore ose ligjore. Kompetencat e Presidentit nuk mund të konsiderohen si pjesë apo ushtrim i një pushteti legjislativ.

20. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

20.1 Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar asnjë lloj pretendimi për mënyrën e mbajtjes dhe/ose zhvillimit të zgjedhjeve vendore. Kërkuesja nuk ka kundërshtuar asnjë akt të ndonjë institucioni që ka të bëjë me zgjedhjet vendore. Një lloj gjykimi i tillë, ku kundërshtohet një fenomen, ndodhi ose ngjarje e caktuar, nuk parashikohet si pjesë e juridiksionit të kësaj Gjykate. Pretendimet për regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike" nuk janë me natyrë kushtetuese, por ligjore.

20.2 Kërkuesja nuk legjitimohet për asnjë nga kërkimet. Referuar statutit ajo nuk merr dhe nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje, për rrjedhojë nuk ka interes të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar procesin zgjedhor dhe as për çështje që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve dhe verifikimin e zgjedhjes në to. Kërkuesja nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së partisë "Bindja Demokratike", sipas nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

20.3 Kërkesa është paraqitur nga një subjekt pa tagra. Shoqata nëpërmjet organeve të saj nuk ka shprehur në asnjë moment vullnetin për t'iu drejtuar Gjykatës, ndaj ndodhemi në kushtet e mosekzistencës së kërkesës. Kjo e fundit është nënshkruar nga një individ që nuk ka asnjë funksion në shoqatë, ndaj kërkesa dhe përfaqësimi rezultojnë të pavlefshme. Po ashtu, kërkesa nuk është e shoqëruar nga prokura/autorizimi përkatës, sipas kërkesave të nenit 4, pika 2, shkronja "ç", të Rregullores së Gjykatës dhe nuk shoqërohet me kopje të përditësuar të statutit.

20.4 Në lidhje me themelin e pretendimeve, dekreti i Presidentit është një akt nënligjor. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës dekretet e Presidenti nuk renditen si akte normative që kanë fuqi në të gjithë territorin. Edhe në kuptim të nenit 94 të Kushtetutës, kompetencat e Presidentit duhet të ushtrohen edhe në bazë të ligjeve që dalin në pajtim me Kushtetutën. Presidenti dhe kompetencat e tij nuk mund të konsiderohen si pjesë ose ushtrim i një pushteti legjislativ, për rrjedhojë edhe dekretet e tij nuk mund të kenë fuqi mbiligjore apo ligjore.

20.5 Kushtetuta ka vetëm një parashikim se kur nuk mund të mbahen zgjedhjet dhe sipas nenit 170 të saj kjo është në kushtet e masave të jashtëzakonshme, ndërsa Kodi Zgjedhor nuk

parashikon asnjë situatë të tillë. Në rastin konkret nuk ka ekzistuar asnjë prej situatave juridike që të kenë provokuar marrjen e masave të jashtëzakonshme, qëndrim që është mbajtur edhe nga Komisioni i Venecies në opinionin CDL-AD(2019)019.

20.6 Vlefshmëria e dekretit është shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka mbajtur qëndrimin se kompetenca e Presidentit lidhet vetëm me caktimin e datës së zgjedhjeve dhe ai nuk ka të drejtë ta anulojë atë, të caktojë data të tjera, si dhe nuk ka autorizimin ligjor për të vepruar në këtë mënyrë (abuzimi me diskrecionin e pretenduar). Ky vendim, në bazë të nenit 142, pika 3, të Kushtetutës, është i detyrueshëm për zbatim, përfshirë edhe KQZ-në. Kolegji Zgjedhor e ka konsideruar veten kompetent që të shqyrtojë vlefshmërinë e dekretit të Presidentit të Republikës, dhe bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, Presidenti mund ta kundërshtonte vendimin në Gjykatën Kushtetuese, në kuadrin e një mosmarrëveshjeje të kompetencave në rrafshin horizontal.

20.7 Pretendimi i cenimit të zgjedhjeve të lira për shkak të mospjesëmarrjes së kandidatëve nga forca të ndryshme politike nuk qëndron, pasi një arsyetim i tillë do të cenonte parimin e periodicitetit të zgjedhjeve, të parashikuar në nenin 1, pika 3, të Kushtetutës. Sovraniteti popullor nuk mund të kufizohet thjesht për arsye se disa forca politike kanë vendosur, me vullnetin e tyre, të mos marrin pjesë në zgjedhje. Kjo qasje do të ishte e gabuar, sepse çdo forcë politike në të ardhmen mund të vendosë të mos marrë pjesë në zgjedhje, duke vënë në dyshim legjitimitetin e tyre.

21. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka paraqitur mendimin këshillimor si vijon:

21.1 Mosrespektimi i thelbit të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parimit të barazisë së armëve, parimit të sigurisë juridike në realizimin e një procesi zgjedhor, sjell konfuzion, si dhe paqartësi tek të gjitha palët dhe subjektet e përfshira në proces, si dhe pasoja për vetë procesin.

21.2 Kushtetuta i ka dhënë tagër të drejtpërdrejtë Presidentit që nëpërmjet dekretit, akt që e nxjerr në ushtrim të kompetencave të tij, të caktojë datën e zgjedhjeve. Ky akt shërben si fillesa e një procesi administrativ, i cili, nga njëra anë, duhet të respektojë të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe, nga ana tjetër, të garantojë të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur.

21.3 Kushtetuta parashikon pluralizmin si një nga bazat e shtetit dhe partitë politike janë një institucion thelbësor dhe i pazëvendësueshëm për jetësimin e demokracisë, baza mbi të cilën ngrihet dhe funksionon pluralizmi politik. Është e drejtë e partive politike të regjistruara në përputhje me kriteret ligjore, që të vendosin për pjesëmarrjen apo jo me cilësinë e subjektit zgjedhor në një proces zgjedhor. Por kjo e drejtë dhe liri nuk duhet të hasë në pengesa të krijuara prej ndërhyrjesh të caktuara, të cilat cenojnë garancinë kushtetuese dhe ligjore për gëzimin dhe ushtrimin efektiv të saj.

21.4 Bojkotimi i zgjedhjeve nga partitë politike nuk i shërben interesit të qytetarëve dhe pritshmërive të tyre të ligjshme ndaj një procesi zgjedhor. Nga ana tjetër, asnjë forcë politike ose shumicë parlamentare nuk mund të pamundësojë konsensusin politik për rregullat në zgjedhje, në mënyrë që ato të kenë legjitimimin e rezultatit, aq i domosdoshëm në një demokraci funksionale.

22. Subjekti i interesuar KQZ-ja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

22.1 Vendimmarrjet e KQZ-së kanë konsideruar se dekreti i Presidentit nr. 10928/2018, përmbush në mënyrë kumulative të gjitha parashikimet ligjore. KQZ-ja, në përputhje me parashikimet ligjore dhe në respektim të parimit të periodicitetit të zgjedhjeve, ka organizuar zhvillimin e zgjedhjeve në datën 30.6.2019. Pretendimi i kërkueses në lidhje me ekzistencën e dy dekreteve të Presidentit nuk qëndron, pasi dekreti nr. 11199/2019 është absolutisht i pavlefshëm. Ndërprerja e organizimit të zgjedhjeve të kësaj date do të cenonte garantimin e së drejtës së zgjedhësve.

22.2 Me nxjerrjen e dekretit për anulimin e datës së zgjedhjeve, Presidenti jo vetëm që ka tejkaluar kompetencat ligjore, por ka marrë kompetencat e Kuvendit si i vetmi organ që ka të drejtë të ndryshojë datën e zgjedhjeve. Edhe Kolegji Zgjedhor në vendimin nr. 12, datë 24.6.2019, ka mbajtur qëndrimin se anulimi i datës së zgjedhjeve në mungesë të kompetencës ligjore dhe në shkelje të afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor bënte që shtetasve shqiptarë t'u mohohej e drejta kushtetuese e votës, e parashikuar nga neni 45 i Kushtetutës.

22.3 Nëpërmjet anulimit të datës së zgjedhjeve bëhej edhe zgjatja e mandatit të organeve të

qeverisjes vendore tej afatit ligjor, çka bie ndesh me nenin 1, pika 3 dhe nenin 2, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës. Cenimi i parimit të periodicitetit në rastin e shtyrjes së zgjedhjeve në nivel vendor, është konstatuar edhe nga Komisioni i Venecies në opinionin e tij.

22.4 Lidhur me pretendimin për regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike", ky subjekt është regjistruar në përputhje me nenin 64 të Kodit Zgjedhor dhe kërkueses i mungon legjitimiteti aktiv e interesi i ligjshëm për të kërkuar verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së kësaj partie.

23. Subjekti i interesuar, partia "Bindja Demokratike", në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

23.1 Kërkuesja nuk ka kundërshtuar asnjë akt të asnjë institucioni që ka të bëjë me zgjedhjet vendore dhe një gjykim i tillë, ku kundërshtohet një fenomen, ndodhi ose ngjarje e caktuar nuk parashikohet si pjesë e juridiksionit kushtetues. Gjykata nuk ka juridiksion sipas nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, për të shqyrtuar asnjë lloj pretendimi në lidhje me mënyrën e mbajtjes dhe/ose të zhvillimit të zgjedhjeve vendore. Pretendimet për regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike" si parti ose edhe si subjekt zgjedhor, nuk janë me natyrë kushtetuese, në kuptim të nenit 9 të Kushtetutës, por kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për partitë politike, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Zgjedhor.

23.2 Kërkuesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për antikushtetutshmërinë e procesit zgjedhor. Ajo nuk është subjekt që merr pjesë në formimin e vullnetit të zgjedhësve, pra nuk ka interes të drejtpërdrejtë dhe vetjak për inicimin e këtij procesi. Për sa i përket kërkimit të dytë, kërkuesja, e organizuar në formën e një shoqate, nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së partive politike.

23.3 Kërkuesja nuk pretendon cenim të rendit kushtetues, përdorimin e dhunës në realizimin e qëllimeve ose ndalime të tjera kushtetuese. Regjistrimi i një partie politike nuk është mosmarrëveshje me palë kundërshtare, por një kërkesë ku gjykata verifikon plotësimin e disa formaliteteve dhe me verifikimin e tyre e pranimin e kërkesës, procesi konsiderohet i mbyllur. Është e pakuptimtë të pritet një afat ankimor kur kërkesa është pranuar dhe nuk ka palë të tjera në këtë proces. Pra partia "Bindja Demokratike" konsiderohet si subjekt i së drejtës dhe ajo mund të regjistrohej për zgjedhjet vendore të vitit 2019.

23.4 Sipas normave kushtetuese, rregullimi i çështjeve zgjedhore mund të bëhet vetëm me ligj të miratuar nga Kuvendi, ndaj Presidenti nuk mundet t'i rregullojë në mënyrë të ndryshme këto marrëdhënie me dekret, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me caktimin e zgjedhjeve dhe vlefshmërinë e tyre. Kjo nënkupton se dekreti i Presidentit në këtë rast duhet të jetë në përputhje me ligjin, për rrjedhojë ai është akt nënligjor.

23.5 Kushtetuta ndalon mbajtjen e zgjedhjeve vetëm në kushtet e masave të jashtëzakonshme, sipas nenit 170, pika 1, dhe në rastin konkret nuk ka ekzistuar asnjë prej situatave të parashikuara nga norma kushtetuese. Në argumentet e saj kërkuesja përpiqet të argumentojë se Presidenti kishte të drejtë që të kryente këto veprime, por dështon që të argumentojë se si mund të ushtrohet ky pushtet dhe ku janë kufijtë e tij.

23.6 Vlefshmëria e dekretit të Presidentit është shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, vendim që është i detyrueshëm për zbatim sipas nenit 142, pika 3, të Kushtetutës. Presidenti, në asnjë rast, nuk e ka kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese vendimin e Kolegjit Zgjedhor, duke pretenduar cenimin e kompetencave të tij nga ana e një pushteti tjetër kushtetues, siç janë gjykatat.

23.7 Kërkuesja dhe Presidenti, duke i mbështetur argumentet e tyre me referencë vetëm në tri parti politike, diskriminojnë partitë e tjera, ndërkohë që sipas KQZ-së, në zgjedhjet e qeverisjes vendore janë regjistruar në total 36 parti politike dhe dy koalicione.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

24. Kërkuesja ka parashtruar se çështja objekt shqyrtimi i takon juridiksionit të kësaj Gjykate, pasi ajo lidhet me respektimin e parimeve dhe të drejtave kushtetuese që kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës, zgjedhjen e një sistemi qeverisjeje bazuar në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike, dinjitetin e njeriut, rendin kushtetues, parimin e ndarjes së pushteteve, kufizimin e të drejtave në mënyrë joproporcionale, diskriminimin e disa zgjedhësve ndaj të tjerëve,

funksionimin e partive politike në përputhje me parimet demokratike, si dhe të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur dhe në këtë drejtim çështja e procesit zgjedhor përbën vetëm një nga pretendimet dhe kërkimet e parashtruara. Sipas saj, parashikimi i shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 131, të Kushtetutës nënkupton nevojën e vlerësimit të mënyrës së zgjedhjes, për sa u përket kritereve që lidhen me ligjin material dhe procedural, si dhe të parimeve dhe të drejtave kushtetuese drejtpërdrejt të zbatueshme.

25. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe partisë "Bindja Demokratike", Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Kërkuesja ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së procesit zgjedhor të zhvilluar më 30.6.2019, por nuk ka kundërshtuar ndonjë akt kushtetues ose ligjor për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve. Një gjykim i tillë, ku kundërshtohet një fenomen, ndodhi ose ngjarje e caktuar, nuk parashikohet si pjesë e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Kurse pretendimet e kërkueses për regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike" si parti ose edhe si subjekt zgjedhor nuk janë me natyrë kushtetuese në kuptim të nenit 9 të Kushtetutës, por kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për partitë politike, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Zgjedhor.

26. Subjekti tjetër i interesuar, Presidenti, ka parashtruar se thelbi i pretendimeve dhe objekti i kërkimit janë antikushtetutshmëria e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të zhvilluar më 30.6.2019. Kurse subjektet e interesuara, Avokati i Popullit dhe KQZ-ja, nuk kanë parashtruar argumente në lidhje me juridiksionin e kësaj Gjykate.

27. Duke pasur parasysh pretendimet e mësipërme, Gjykata vlerëson të ndalet në çështjen e juridiksionit të saj kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

28. Gjykata, referuar objektit të kërkesës në shqyrtim, vëren se kërkuesja ka ngritur dy kërkime: *i pari* lidhet me konstatimin si antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të zhvilluar në datën 30.6.2019, për rrjedhojë konstatimin antikushtetues të zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve; *i dyti* ka të bëjë me verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike" në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë për këto zgjedhje vendore. Në lidhje me bazën kushtetuese ku janë mbështetur këto kërkime, Gjykata vëren se kërkuesja i referohet përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronjat: "e", "d" dhe "f", të Kushtetutës. Në seancën plenare të datës 2.11.2021, kërkuesja i kërkoi Gjykatës që ta shqyrtojë çështjen përtej bazës kushtetuese të kërkimeve të parashtruara prej saj, në zbatim të parimit *iura novit curia.*

29. Gjykata, bazuar në objektin e kërkesës, por edhe në thelbin e pretendimeve, vlerëson se kërkimi i parë për kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor të zhvilluar më 30.6.2019, *prima facie* duket se përfshihet në fushën e veprimit të shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 131, të Kushtetutës, kurse kërkimi i dytë për kushtetutshmërinë e veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike" në pikën "d", të po këtij neni.

30. Për sa i takon referimit të kërkueses në shkronjën "f", të pikës 1, të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se, në kuptim të kësaj dispozite, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund ta vërë atë në lëvizje për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Gjykata vëren se, ashtu siç pretendohet edhe nga subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe partia "Bindja Demokratike", kërkuesja jo vetëm që nuk është subjekt zgjedhor, për rrjedhojë as bartëse e të drejtave kushtetuese që lidhen me këtë proces, por ajo nuk ka konkretizuar në kërkesën e saj as ndonjë akt të pushtetit publik ose një vendim gjyqësor, i cili mund të kundërshtohej në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Prandaj kjo dispozitë nuk mund të shërbejë si bazë kushtetuese për kërkimet e parashtruara nga kërkuesja.

31. Për sa më sipër, Gjykata do të analizojë kërkimin e parë në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, sipas të cilit ajo vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, të deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre, dhe kërkimin e dytë të lidhur me nenin 131, pika 1, shkronja "d", të saj, sipas të cilit ajo vendos për kushtetutshmërinë e partive dhe organizatave të tjera politike, si dhe

veprimtarinë e tyre, në kuptim të nenit 9 të Kushtetutës. Në vijim, Gjykata do të ndalet në vlerësimin e juridiksionit të saj veçmas për secilin kërkim.

32. Gjykata vëren se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, i cili, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ka këtë përmbajtje: "*1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës*". Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim. Interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Për të shmangur çdo mundësi për ndërhyrje në kompetencat e pushtetit ligjvënës, Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por synon t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre *(shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse *(shih vendimet nr. 29, datë 30.6.2011; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 2, datë 19.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa më sipër, neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin themelor të kësaj Gjykate, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Në këtë kuptim, koncepti "mosmarrëveshje kushtetuese" në nenin 124 të Kushtetutës e merr përmbajtjen e tij dhe përfshin çështjet kushtetuese që janë të parashikuara jo vetëm nga neni 131 i Kushtetutës, por edhe nga çdo dispozitë tjetër kushtetuese, mbi bazën e të cilave Gjykata ushtron kompetencat e saj.

34. Në këtë drejtim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se neni 131 i Kushtetutës, që përcakton kompetencat kryesore të saj, dhe neni 134 i saj, që përcakton subjektet që e vënë në lëvizje, nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate. Kjo sepse normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluara, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre *(shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se çdo normë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me normat e tjera dhe, së bashku, ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara. Çdo normë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që ajo nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete *(shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 8, datë 8.3.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në nenin 4, pika 3, i Kushtetutës përcaktohet se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur vetë ajo parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota

ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet (*shih vendimet nr. 55, datë 27.7.2016; nr. 22, datë 24.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka nënvizuar se atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla (...) atje ku nuk është shprehur (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 25, datë 15.12.2008; nr. 212, datë 29.12.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren se neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës, parashikon se ajo vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Nisur nga fakti se pretendimi thelbësor i kërkueses ka të bëjë me kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor vendor të datës 30.6.2019, Gjykata, për përcaktimin e juridiksionit të saj, do të interpretojë përmbajtjen e kësaj norme kushtetuese sipas metodave të interpretimit literal, sistematik dhe qëllimor, por edhe atij historik. Më konkretisht, ajo do të analizojë nëse në përcaktimet e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës përfshihet edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor të funksionarëve vendorë, dhe për këtë qëllim do të shqyrtojë konceptet "*funksionarët e organeve të parashikuara në Kushtetutë*" dhe "*verifikimin e zgjedhjes së tyre*" që gjenden në përmbajtjen e këtij neni.

38. Nga pikëpamja e kontekstit historik, me ligjin nr. 137/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", të miratuar në kuadër të reformës për dekriminalizimin, kushtetutëbërësi shtoi nenin 6/1, që synon ndalimin e zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik, si dhe ushtrimin e këtij funksioni, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, dhe nenin 179/1, i cili parashikon përfundimin ose pavlefshmërinë e mandatit të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, i fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rastet kur i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë të përjashtuara nga e drejta për t'u zgjedhur, sipas neneve 6/1 dhe 45, pika 3, të Kushtetutës.

39. Ky ligj ndryshoi përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, duke shtuar në të edhe kontrollin e çështjeve që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve dhe verifikimin e zgjedhjes së funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, përveçse atyre që kanë të bëjnë me Presidentin dhe deputetët.

40. Gjykata konceptin "*organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë*" e ka interpretuar sipas neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja "a", të Kushtetutës, duke vlerësuar se bëhet fjalë për institucionet kushtetuese, struktura bazë e të cilave përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë e të plotë nga Kushtetuta ose për institucionet të cilat nëpërmjet Kushtetutës fitojnë personalitet juridik dhe kompetencë kushtetuese (*shih vendimin nr. 25, datë 5.12.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Organet e qeverisjes vendore janë organe "të parashikuara në Kushtetutë", ndërsa këshilltarët në këshillat bashkiakë dhe kryetarët e bashkive janë funksionarë "që ushtrojnë funksione publike në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë" dhe se fjala "funksionarë" në nenin 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës ka të njëjtin kuptim me personat "që ushtrojnë funksione publike" në nenin 6/1 të saj (*shih paragrafët 16–18 të Opinionit CDL-AD(2021)026*).

42. Gjykata vëren se sipas nenit 108, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet, të cilat kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, ndërkohë që sipas nenit 109, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës organet përfaqësuese të tyre janë këshillat dhe organi ekzekutiv është kryetari. Pra, organet e qeverisjes vendore janë organe të parashikuara nga Kushtetuta dhe kompetencat e tyre burojnë nga kjo e fundit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe për sa u takon funksionarëve të zgjedhur vendorë, në juridiksionin e saj, sipas shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 131, të Kushtetutës, përfshihen çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë, si dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre, pra të anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe kryetarit të bashkisë, si funksionarë publikë.

43. Gjykata në vijim do të ndalet në analizën e togfjalëshit "*verifikimin e zgjedhjes së tyre*" në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të

Kushtetutës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e procedurës për zgjedhjen e funksionarëve të parashikuar në këtë dispozitë.

44. Gjykata vëren se në kreun VII, të ligjit nr. 8577/2000, "Për procedurat e veçanta", është rregulluar procedura për zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të Presidentit dhe të deputetëve, ku përfshihen subjektet kërkuese, afatet e kërkesës dhe vendimmarrja e Gjykatës (nenet 64–67), por nuk përmban ndonjë parashikim në lidhje me shkaqet dhe mënyrën se si vihet në lëvizje Gjykata për verifikimin e zgjedhjes së tyre. Ligji organik i Gjykatës, edhe pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 99/2016, nuk përmban dispozita që rregullojnë procedurën në rastet e paraqitjes së kërkesës për zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre. Ndërkohë, në nenin 71/d të atij ligji, që është përfshirë në pjesën që rregullon procedurat për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual, parashikohen rastet kur Gjykata vihet në lëvizje, në kuptim të nenit 179/1 të Kushtetutës, dispozitë tranzitore, e shtuar me ligjin nr. 137/2015, për pavlefshmërinë ose mbarimin e mandatit të funksionarëve në detyrë në kohën e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese për dekriminalizimin.

45. Ndonëse ndryshimet në ligjin organik të Gjykatës janë miratuar pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, që kanë të bëjnë me reformën e dekriminalizimit, dhe nuk përcaktojnë procedura të veçanta të gjykimit kushtetues, për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre, kjo gjithsesi nuk nënkupton që nëse plotësohen kriteret e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, Gjykata nuk ka juridiksion në lidhje me çështjet e përcaktuara në këtë dispozitë.

46. Në analizë të përmbajtjes së dispozitave kushtetuese që lidhen me kompetencën e Gjykatës, nga njëra anë, dhe atyre që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, nga ana tjetër, vlerësohet se kompetenca e Gjykatës nuk përfshin shqyrtimin e vlefshmërisë së zgjedhjeve vendore (*shih paragrafin 28, të Opinionit CDL-AD(2021)026*). Legjislacioni i miratuar nga Kuvendi, si Kodi Zgjedhor, ashtu dhe ligji për Gjykatën, tregon një kuptim dhe interpretim të përbashkët që Gjykata nuk duhet të jetë një arbitër i përgjithshëm i ankimeve zgjedhore. Këto ligje janë prova e një historie legjislative dhe interpretuese që duhet të merret në konsideratë. Për këtë arsye, shprehja "verifikimin e zgjedhjes së tyre" duhet të interpretohet ngushtësisht, duke mbuluar çështjen e së drejtës për t'u zgjedhur, por jo të gjitha procedurat zgjedhore (*shih paragrafin 25, të Opinionit CDL-AD (2021)026*).

47. Gjykata thekson se përmbajtja e shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 131 të Kushtetutës, nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së këtyre funksionarëve publikë.

48. Në lidhje me institutet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë, Gjykata thekson se pazgjedhshmëria synon të ndalojë një kandidat të caktuar që të mund të emërohet në një funksion publik ose të fitojë një mandat nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në zgjedhje, kurse papajtueshmëria ka të bëjë me ndërprerjen e funksionit ose mandatit në rast se verifikohen shkaqe që nuk lejojnë ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të tij. Në çdo rast, si shkak pazgjedhshmërie ose papajtueshmërie shërbejnë fakte, rrethana ose sjellje që ndalojnë emërimin ose zgjedhjen, ose bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit publik, të cilat mund të jenë të parashikuara nga norma kushtetuese apo në ligje të veçanta. Instituti i papajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit ose funksionit dhe synon parandalimin e mbivendosjes së kompetencave të ndara tek i njëjti person ose organ, në këtë mënyrë moscenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si element i shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 44, datë 7.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Duke iu referuar jurisprudencës së lartpërmendur, Gjykata vëren se kontrolli kushtetues për këto çështje ka natyrë individuale, pasi bazohet në vlerësimin e shkeljes konkrete për ato ndalime kushtetuese ose ligjore që përbëjnë shkak për konstatimin e papajtueshmërisë ose pazgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

50. Duke i analizuar dispozitat kushtetuese në mënyrë integrale dhe harmonike, Gjykata vlerëson

se në ushtrimin e kompetencës së parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, edhe verifikimi i zgjedhjes së funksionarëve të parashikuar nga kjo dispozitë ka natyrë individuale, pasi përpara termit "organeve të parashikuara në Kushtetutë" dispozita ka vendosur termin "funksionarët", për të theksuar se çështjet e këtij neni lidhen me funksionarin dhe jo me organin ku ai ushtron funksionin publik. Në vlerësimin e Gjykatës termi "organeve të parashikuara në Kushtetutë" në këtë dispozitë, nuk është vendosur për t'i dhënë Gjykatës juridiksion për verifikimin e zgjedhjes së tyre, por për të shoqëruar termin "funksionarët", në mënyrë që fusha e kontrollit kushtetues të kufizohet vetëm ndaj funksionarëve të organeve të parashikuara nga Kushtetuta dhe jo ndaj çdo funksionari publik.

51. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se neni 115 i Kushtetutës rregullon procedurat e ankimit kushtetues në rastet e shkarkimit ose të shpërndarjes së organit të zgjedhur të njësisë qeverisëse vendore, por nuk përdor termin "funksionar", ndonëse procedurat e kontrollit kushtetues sipas kësaj dispozite janë me natyrë individuale, pasi ky lloj gjykimi ka për objekt një akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.5.2021; nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 37, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese).*

52. Në vlerësimin e Gjykatës, në rastin e parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, kushtetutëbërësi nuk ka përdorur termin "funksionar", edhe pse ai mund të përkojë me organin, sepse qëllimi i këtij neni është mbrojtja e organeve të qeverisjes vendore, të cilat ngrihen dhe funksionojnë sipas parimeve të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. Kjo normë kushtetuese përcakton shprehimisht juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar shkarkimin e këtyre organeve, e cila përbën një lloj të veçantë të kontrollit kushtetues, që nuk u referohet rasteve të pazgjedhshmërisë apo papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës, apo zgjedhjes së këtyre funksionarëve. Në ndryshim nga kjo dispozitë, në çështjet e përfshira në rregullimin e shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 131, jo vetëm që bëhet fjalë për individin, që merr funksion zyrtar, por qëllimi i saj është mbrojtja e interesit publik që në organe të parashikuara nga Kushtetuta funksionarët të zgjidhen sipas procedurave kushtetuese përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë dhe pajtueshmërisë me funksionin.

53. Në këtë kuptim, me qëllim ushtrimin e kompetencës së parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "e", i Kushtetutës, kërkesa drejtuar Gjykatës për verifikimin e zgjedhjes duhet të identifikojë funksionarin publik, shkeljen kushtetuese që pretendohet se është kryer gjatë procesit të zgjedhjes së tij, si dhe aktin konkret që materializon shkeljen kushtetuese. Për pasojë, procedura e verifikimit të zgjedhjes së funksionarëve të organeve të parashikuara nga Kushtetuta duhet parë e lidhur me këto koncepte dhe jo e lidhur me vlerësimin, qoftë edhe në aspektin e kushtetutshmërisë, të procesit zgjedhor në tërësinë e tij.

54. Ky qëndrim përforcohet duke pasur parasysh edhe përmbajtjen e shkronjës "ë", të pikës 1, të nenit 131, në të cilin parashikohet kompetenca e Gjykatës për të vendosur për kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij, duke qenë i qartë kushtetutëbërësi në formulimin e kësaj dispozite, për sa u takon atyre çështjeve që mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Në ndryshim nga ky formulim, në shkronjën "e" të po kësaj dispozite, Gjykatës nuk i jepet shprehimisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë kompetenca për të vendosur për kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor dhe verifikimin e rezultateve të tij.

55. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata vlerëson se kushtetutëbërësi, duke mos e parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kompetencën për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor, ka pasur si qëllim të mos përfshijë në juridiksionin kushtetues kontrollin e procedurave zgjedhore në tërësinë e tyre. Për këtë arsye, në kontekstin e çështjes konkrete në shqyrtim, togfjalëshi "verifikimin e zgjedhjes së tyre" në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës duhet të interpretohet në kuptimin që ai ka të bëjë me verifikimin e respektimit të së drejtës individuale për t'u zgjedhur të funksionarit të organit kushtetues gjatë procesit zgjedhor.

56. Gjykata konstaton se, edhe në vështrimin historik vullneti i ligjvënësit ka qenë i qartë lidhur me ndarjen e juridiksionit kushtetues nga ai gjyqësor, në varësi të natyrës së zgjedhjeve, kombëtare të përgjithshme ose vendore. Me Kodin Zgjedhor të vitit 2000 (të miratuar me ligjin nr.

8609, datë 8.5.2000) u parashikua kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankimet për rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin dhe referendumet dhe pavlefshmërinë e tyre, si dhe kompetenca e Gjykatës së Lartë lidhur me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve vendore dhe pavlefshmërinë e tyre (neni 141, pikat 1 dhe 2). Megjithatë, kontrolli i ushtruar nga Gjykata gjatë asaj periudhe përqendrohej vetëm në aspektin e ligjshmërisë, çka e shndërronte atë në një gjykatë fakti, duke i dhënë një natyrë tjetër gjykimit kushtetues.

57. Kodi Zgjedhor i miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.6.2003, i cili shfuqizoi ligjin nr. 8609, datë 8.5.2000, të ndryshuar, përcaktoi Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë si organin kompetent për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të KQZ-së. Megjithatë, dispozita kushtetuese, shkronja "e", e pikës 1, të nenit 131, mbeti e pandryshuar dhe përmbajtja e saj nuk rezulton të ketë gjetur pasqyrim ose zbërthim as në dispozitat e Kodit Zgjedhor në fuqi, i miratuar me ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008. Në nenin 124 të këtij kodi, parashikohet e drejta e ankimit administrativ të çdo partie politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati të propozuar nga zgjedhësit kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm. Sipas nenit 143, pika 1, shkronja "ç", të tij, në përfundim të shqyrtimit të ankimit, KQZ-ja vendos, sipas rastit, shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore. Kurse sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore, si dhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm.

58. Edhe Komisioni i Venecies është shprehur se ankimet zgjedhore kundër vendimeve të KQZ-së ose mungesës së vendimmarrjes, shqyrtohen nga Kolegji Zgjedhor, i cili ka kompetencën për të kontrolluar ligjshmërinë e tyre dhe vihet në lëvizje me kërkesë të subjekteve që legjitimohen, çka do të thotë se në këto raste legjislacioni ka parashikuar mjete ligjore në dispozicion (*shih paragrafin 23, të Opinionit CDL-AD(2021)026*).

59. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kushtetutëbërësi nuk ka pasur qëllim t'i japë asaj kompetencën për të vlerësuar kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor në tërësinë e tij, ndaj dhe modalitetet e këtij procesi, si subjektet që e vënë në lëvizje Gjykatën, afatet, procedurat dhe lloji i vendimmarrjes për këtë lloj kontrolli, nuk gjenden as në ligjin organik, as në Kodin Zgjedhor. Sipas nenit 124, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata i nënshtrohet vetëm kësaj të fundit dhe përderisa një kompetencë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, nuk mund të ushtrohet prej saj. Gjykata rithekson se kompetencat e saj nuk mund të ndryshohen, të ngushtohen ose të zgjerohen, përveçse me ligj kushtetues (*shih vendimet nr. 212, datë 29.10.2002; nr. 34, datë 24.9.1996, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në parashtrimet e datës 2.11.2021, kërkuesja është shprehur se para Gjykatës nuk shtrohet vetëm çështja e procesit, pasi ai është vetëm një nga pretendimet e kërkesës, por ajo e respektimit të parimeve dhe të drejtave kushtetuese, siç janë e drejta për t'u zgjedhur, parimet themelore të shtetit të së drejtës, zgjedhja e një sistemi qeverisjeje bazuar në zgjedhje të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike, ndarja e pushteteve, kufizimi i të drejtave në mënyrë joproporcionale, diskriminimi etj., juridiksioni për shqyrtimin e të cilave i takon vetëm kësaj Gjykate. Pavarësisht këtyre pretendimeve, bazuar në sa u arsyetua më sipër, Gjykata vlerëson se në çështjen e paraqitur nga kërkuesja nuk është individualizuar funksionari/funksionarët e organeve kushtetuese, për të cilët kërkohet verifikimi i zgjedhjes së tyre, shkelja kushtetuese që pretendohet se është kryer gjatë procesit të zgjedhjes, si dhe akti konkret që materializon shkeljen kushtetuese. Nga ana tjetër, kërkuesja nuk është as subjekt zgjedhor dhe as organ kushtetues me kompetenca në procesin zgjedhor.

61. Për sa më lart, kërkimi për konstatimin antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar në datën 30.6.2019, për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, mbetet jashtë juridiksionit kushtetues, ndaj Gjykata nuk mund të investohet në lidhje me këtë çështje.

62. Megjithatë, nisur nga sa u konstatua nga rrethanat e kësaj çështjeje dhe pretendimet e palëve, Gjykata vëren se përgjatë procesit zgjedhor për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të zhvilluar në qershor të vitit 2019, ka pasur mosmarrëveshje midis subjekteve që kanë

kompetenca në lidhje me caktimin e datës së zgjedhjeve dhe zhvillimin e këtij procesi, të cilat kanë interpretuar në mënyra të ndryshme parashikimet kushtetuese ku janë mbështetur për ushtrimin e kompetencave të tyre, gjë që, siç ka evidentuar misioni vëzhgues i ODHIR-it, "*krijoi një klimë ngërçi dhe polarizimi politik dhe votuesit nuk patën një mundësi kuptimplotë për të zgjedhur mes disa opsioneve politike*" (*shih faqen 1 të Raportit*). Gjithsesi, asnjë prej subjekteve që legjitimohet të vërë në lëvizje këtë Gjykatë, nuk i është drejtuar me kërkesë për zgjidhjen e konflikteve me natyrë kushtetuese që bëjnë pjesë në juridiksionin e saj (*shih paragrafin nr. 33 të këtij vendimi*).

63. Për sa i përket kërkimit të dytë të kërkueses, atij për verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike", Gjykata vëren se kjo kompetencë e saj është e parashikuar në mënyrë të shprehur në shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 131 të Kushtetutës, për rrjedhojë ai bën pjesë në juridiksionin kushtetues.[1]

B. Për legjitimimin e kërkueses

64. Gjykata, për sa kohë që ka vlerësuar mungesën e juridiksionit kushtetues për kërkimin e parë të parashtruar në kërkesën në shqyrtim, atë që lidhet me konstatimin antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar më 30.6.2019, për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë, dhe si rrjedhojë konstatimin antikushtetues të zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve, do të ndalet në vlerësimin e legjitimimit të kërkueses vetëm në lidhje me kërkimin për verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike", në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30.6.2019.

65. Në jurisprudencën kushtetuese, çështja e legjitimimit (*locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

66. Për sa i përket legjitimimit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 21, datë 28.4.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

67. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe partisë "Bindja Demokratike", kërkuesja nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së partisë "Bindja Demokratike", në kuptim të nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000. Edhe subjekti i interesuar, KQZ-ja, ka vënë në dyshim legjitimitetin e kërkueses dhe interesin e saj të ligjshëm për të kërkuar verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë "Bindja Demokratike".

68. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (*shih vendimin nr. 78, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, shoqatat legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës. Megjithatë, kjo e drejtë është e kushtëzuar dhe ajo mund të

[1] Anëtarja M. Xhaferllari ka votuar për përfshirjen e këtij kërkimi si argument në funksion të kërkimit të parë.

ushtrohet vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Vetëm nëse përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2, i nenit 134, të Kushtetutës, për të argumentuar "interesin e tyre" në një "çështje të veçantë", shoqatat legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës në lidhje me prerogativën e saj për të vendosur, në këtë rast, për pajtueshmërinë e ligjit ose aktit normativ me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 17, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

69. Gjykata konstaton se kërkuesja e ka bazuar legjitimimin e saj në nenin 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës dhe në nenin 49, pika 3, shkronja "d", të ligjit nr. 8577/2000, duke pretenduar se ekziston lidhja e domosdoshme ndërmjet veprimtarisë së saj dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Edhe në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, ajo i referohet dispozitës që përcakton afatin 2-vjeçar për kundërshtimin në Gjykatë të ligjeve ose akteve të tjera normative.

70. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "d", të Kushtetutës, Gjykata vendos për kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute. Verifikimi i kushtetutshmërisë së partive politike është kompetencë kushtetuese që vetë Kushtetuta e ka orientuar në procedura të mirëpërcaktuara. Këto procedura janë të përcaktuara jo vetëm në drejtim të organit që i shqyrton në instancë të parë çështjet e zgjedhshmërisë, por edhe të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe të vendimmarrjes eventuale të saj. Ky lloj kontrolli që ushtron Gjykata në secilin rast kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji, duke u vënë në lëvizje nga subjektet e parashikuara për paraqitjen e kërkesës për këtë lloj procedure.

71. Për verifikimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 57, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të jo më pak se një të pestës së deputetëve, të Avokatit të Popullit dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë kërkim kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae*, duke qenë se nuk bën pjesë në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për ushtrimin e kompetencës së saj të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "d", të Kushtetutës.

72. Për më tepër, neni 9 i Kushtetutës ka parashikuar se cilat janë ato veprimtari të partive politike që ndalohen të ushtrohen. Ndërkohë që pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me procedurën e regjistrimit të partisë "Bindja Demokratike" dhe pjesëmarrjen e saj në zgjedhje, duke mos qenë e regjistruar sipas ligjit, të cilat në thelb janë pretendime me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese.

73. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në lidhje me kërkimin e parë të kërkesës në shqyrtim çështja nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues, kurse në lidhje me kërkimin e dytë kërkuesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat "d" dhe "e", dhe 134, pikat 1, shkronja "h", e pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.11.2021.
Shpallur më 2.12.2021.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Përparim Kalo, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Për arsye se ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me zgjidhjen e çështjes për kërkimin e parë por kam qasje të ndryshme mbi arsyetimin e saj, unë argumentoj sa vijon.

2. Kërkuesja ka pretenduar se zhvillimi i procesit zgjedhor në datën 30.6.2019, ka cenuar parimin e shtetit të së drejtës, për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve në kundërshtim me dekretin e dytë të Presidentit, i cili ka caktuar datën e mbajtjes së zgjedhjeve dhe, rrjedhimisht, përbën bazën urdhëruese për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (*KQZ*) për të filluar përgatitjet, si dhe shënon edhe lindjen e të drejtave dhe detyrimeve të tjera për subjektet politike dhe zgjedhësit, duke përfshirë edhe kompetencën materiale të Kolegjit Zgjedhor. Po kështu, kërkuesja ka parashtruar se çështja objekt shqyrtimi i takon juridiksionit të kësaj Gjykate, pasi ajo lidhet me respektimin e parimeve dhe të të drejtave kushtetuese që kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës, zgjedhjen e një sistemi qeverisjeje, bazuar në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike, dinjitetin e njeriut, rendin kushtetues, parimin e ndarjes së pushteteve, kufizimin e të drejtave në mënyrë jo proporcionale, diskriminimin e disa zgjedhësve ndaj të tjerëve, funksionimin e partive politike në përputhje me parimet demokratike, si dhe të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur dhe në këtë drejtim, çështja e procesit zgjedhor përbën vetëm një nga pretendimet dhe kërkimet e parashtruara. Sipas kërkueses, parashikimi i nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës nënkupton nevojën e vlerësimit të mënyrës së zgjedhjes, për sa u përket kritereve që lidhen me ligjin material dhe procedural, si dhe parimeve dhe të drejtave kushtetuese drejtpërdrejt të zbatueshme.

3. Shumica ka analizuar kërkimin e parë në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, sipas të cilit ajo vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, të deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre, dhe kërkimin e dytë të lidhur me nenin 131, pika 1, shkronja "d" të saj, sipas të cilit ajo vendos për kushtetutshmërinë e partive dhe organizatave të tjera politike, si dhe veprimtarinë e tyre, në kuptim të nenit 9 të Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 31, të vendimit*).

4. Ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën se, nisur nga sa u konstatua nga rrethanat e kësaj çështjeje dhe pretendimet e palëve, Gjykata Kushtetuese vëren se përgjatë procesit zgjedhor për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të zhvilluar në qershor të vitit 2019, ka pasur mosmarrëveshje midis subjekteve që kanë kompetenca në lidhje me caktimin e datës së zgjedhjeve dhe zhvillimin e këtij procesi, të cilat kanë interpretuar në mënyra të ndryshme parashikimet kushtetuese ku janë mbështetur për ushtrimin e kompetencave të tyre, gjë që, siç ka evidentuar misioni vëzhgues i ODHIR-it, "*krijoi një klimë ngërçi dhe polarizimi politik dhe votuesit nuk patën një mundësi kuptimplotë për të zgjedhur mes disa opsioneve politike*" (*shih faqen 1 të Raportit*). Gjithsesi, asnjë prej subjekteve që legjitimohet të vërë në lëvizje këtë Gjykatë, nuk i është drejtuar me kërkesë për zgjidhjen e konflikteve me natyrë kushtetuese që bëjnë pjesë në juridiksionin e saj (*shih paragrafin nr. 62 të vendimit*).

5. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se kërkimi për konstatimin antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar në datën 30.6.2019, për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe, si rrjedhojë, konstatimi antikushtetues i zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin nr. 73 të vendimit*).

6. Në mendimin tim ky përfundim i vlerësimit të shumicës nuk reflekton të gjitha mënyrat e mundshme të interpretimit kushtetues të dispozitave dhe parashikimeve kushtetuese, që përcaktojnë dhe përkufizojnë juridiksionin dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, mendoj se në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk duhet të kishte shqyrtuar pretendimin e kërkueses nën dritën e interpretimit të ngushtë të nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit të të zgjedhurve vendorë (*shih paragrafin nr. 37, të vendimit*).

7. Në argumentimin e qëndrimit tim, vlerësoj të evidentoj disa momente kyçe që shenjuan shfaqjen e një mosmarrëveshjeje që, në thelb, kulmoi me një krizë dhe ngërç të konsiderueshëm kushtetues, e

detajuar më konkretisht: 1. dorëzimi në bllok i mandateve nga ana e partive opozitare; 2. braktisja e parlamentit nga ana e forcave politike opozitare; 3. në rrjedhojë të këtyre veprimeve, vendet e braktisura në Parlament u plotësuan me deputetë nga pjesa e mbetur e listave, duke e reduktuar ndjeshëm në këtë mënyrë numrin e ligjvënësve, të përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës nga 140 deputetë në numrin përfundimtar prej 122 deputetë; 4. zhvillimi i protestave të njëpasnjëshme që shpesh herë sollën edhe përshkallëzim të situatës me shfaqje dhune; 5. mohimi i komisionerëve për zgjedhjet e qershorit 2019, që duhet të caktoheshin nga partitë opozitare; 6. KQZ-ja pas një mohimi të tillë mbeti një organ i përbërë me përfaqësues vetëm nga njëra forcë politike; 7. menjëherë pas këtij fakti opozita deklaroi se nuk do të merrte pjesë në zgjedhjet e qershorit 2019; 8. pas dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018, të Presidentit të Republikës, partitë kryesore të opozitës nuk u regjistruan në zgjedhje; 9. si pasojë e situatës së protestave të dhunshme, Presidenti i Republikës, pas sinjalizimeve (nga agjencitë ligjzbatuese) për dhunë ekstreme që do vinin në rrezik sigurinë kombëtarë të vendit, me dekretin nr. 11199, datë 10.6.2019, e shfuqizoi dekretin e parë; 10. Presidenti i Republikës pas disa tentativave për konsultime të përbashkëta me forcat politike, të cilat nuk arritën të krijonin amalgamën pozitive të duhur, me dekretin nr. 11211, datë 27.6.2019, caktoi datën 13 tetor 2019, si datë zyrtare për zhvillimin e zgjedhjeve lokale; 11. ky dekret i Presidentit të Republikës nuk u botua kurrë në Fletoren Zyrtare dhe as nuk u ankimua nga asnjë prej subjekteve zgjedhore përpara asnjë organi gjyqësor; 12. pas këtij dekreti të Presidentit të Republikës, vetëm disa parti opozitare u regjistruan në zgjedhjet e tetorit të vitit 2019, kurse disa të tjera nuk u regjistruan; 13. KQZ-ja bëri objekt shqyrtimi në kërkesën për çregjistrim të një partie politike (Partia Uniteti Kombëtar), edhe dekretin nr. 11199, datë 10.6.2019, të Presidentit të Republikës, kur ndërkohë ky akt nuk ishte objekt kërkimi e, për më tepër, që Presidenti i Republikës nuk ishte palë në këtë gjykim; 14. Kolegji Zgjedhor e thelloi më tej krizën e krijuar duke gjykuar dhe më pas duke vendosur mbi një objekt që nuk ishte kërkim në gjykim, siç ishte dekreti i Presidentit të Republikës.

8. Për sa më sipër parashtruar, parë në këndvështrim të një fragmentarizimi të tejskajshëm të një krize kushtetuese të lidhur ngushtë me një mosfunksionim institucional disa kahesh, të gjitha sa u thanë, në thelb, përbëjnë atë që në mendimin tim kulmon mosmarrëveshjen kushtetuese, procesi zgjedhor i qershorit 2019, i cili u zhvillua në një klimë tejet të acaruar politike e shoqërore. Kështu, në disa bashki, në më shumë se gjysmat, konkretisht në 31 të tilla, mori pjesë vetëm 1 kandidat, duke mos u ofruar mundësi qytetarëve të zgjidhnin alternativën e dëshiruar, dhe në këtë mënyrë, u evidentuan edhe preferencat politike të qytetarëve, çka përbën mohim të së drejtës së votës dhe cenim të së drejtës kushtetuese për votë të barabartë, të lirë dhe të fshehtë, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës.

9. Në vijim, vlerësoj se thelbi i kërkimit të kërkueses lidhej me respektimin e parimeve dhe të drejtave kushtetuese, si: e drejta për t'u zgjedhur, parimet themelore të shtetit të së drejtës, zgjedhja e një sistemi qeverisjeje bazuar në zgjedhje të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike, ndarja e pushteteve, kufizimi i të drejtave në mënyrë joproporcionale, diskriminimi, juridiksioni për shqyrtimin e të cilave i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese.

10. Neni 124 i Kushtetutës përcakton kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, sa herë që ajo vihet në lëvizje, sipas nenit 131 të Kushtetutës dhe nga subjektet e legjitimuara sipas nenit 134 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se çdo normë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Çdo dispozitë kushtetuese është në një lidhje të caktuar me dispozitat e tjera dhe, së bashku, ato formojnë një entitet. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete *(shih vendimet nr. 29, datë 30.6.2011; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 2, datë 19.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, në lidhje me objektin e këtij kërkimi dhe sidomos në këndvështrimin tim të një çështjeje të tillë që lidhet ngushtë me një mosmarrëveshje kushtetuese, çka e bënte të domosdoshme investimin e juridiksionit kushtetues për zgjidhjen e saj, kam ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën se kërkuesja nuk

legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih paragrafin nr. 73 të vendimit*).

12. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë Gjykata Kushtetuese, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe shteruese se cilat subjekte mund të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Për të gjitha sa u argumentua në këtë mendim, duke marrë në konsideratë edhe natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, e cila, në vlerësimin tim, në thelb është mosmarrëveshje kushtetuese ndërmjet institucioneve shtetërore, shqyrtimi i saj do të bëhej nëse kërkesa do të paraqitej përpara Gjykatës Kushtetuese nga subjektet që legjitimohen për një kërkim të tillë.

13. Në përfundim, vlerësoj se në këtë çështje duhej të arrihej në konkluzionin se Gjykata Kushtetuese, sipas Kushtetutës, gëzon juridiksion kushtetues të plotë që të shqyrtojë mosmarrëveshjen objekt gjykimi, por për shkak se kërkesa nuk është paraqitur nga një prej subjekteve që legjitimohen për ta vënë në lëvizje atë, sidomos subjektet e përcaktuara nga vetë Kushtetuta si të tilla që të mund të kërkojnë gjykimin e një mosmarrëveshjeje kushtetuese lidhur me përcaktimet e nenit 124 të Kushtetutës, kërkesa rrëzohet vetëm për këtë shkak. Ky qëndrim është tërësisht në të njëjtën linjë dhe mban në konsideratë edhe gjetjet e Komisionit Evropian në dy raportet për Shqipërinë 2019 dhe 2020, të publikuara përkatësisht në datën 29.5.2019 dhe në datën 6.10.2020, ku, ndër të tjera, janë theksuar problematikat si pasojë e polarizimit intensiv politik për shkak të situatës së zgjedhjeve. Në raportin për Shqipërinë 2020 thuhet: "*Më 30 qershor 2019, Shqipëria mbajti zgjedhjet lokale në një mjedis politik shumë të polarizuar. Pas heqjes dorë në bllok të mandateve parlamentare në shkurt të vitit 2019 dhe pas muajve të protestave në rrugë, opozita vendosi t'i bojkotojë zgjedhjet. Më 8 qershor, për arsye të kërcënimeve ndaj sigurisë, Presidenti dekretoi anulimin e dekretit të tij të mëparshëm që përcaktonte datën e zgjedhjeve dhe shpalli datën 13 tetor si datën e re të zgjedhjeve. Dekreti i Presidentit u shpërfill nga shumica në pushtet dhe nga organet e administratës zgjedhore.*"[2]. Në deklaratën e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, Misioni i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, ndër të tjera, është shprehur: "*Zgjedhjet vendore të 30 qershorit u mbajtën pa e marrë shumë në konsideratë interesin e elektoratit. Opozita vendosi të mos marrë pjesë, kurse qeveria u tregua e vendosur për t'i mbajtur zgjedhjet pa opozitën. Në një klimë ngërçi dhe polarizimi politik, votuesit nuk e patën mundësinë të zgjidhnin mes disa opsioneve politike.*"[3].

14. Ndaj në përfundim, mendimi im paralel është se kjo çështje e lidhur me kërkimin e parë të saj do të ishte mundur të gjykohej në mënyrë shteruese nga Gjykata Kushtetuese, nëse do të ishte kërkuar kontrolli kushtetues nga një prej subjekteve që vetë Kushtetuta përcakton si subjekt që legjitimohet si i tillë për kërkimet që lidhen me mosmarrëveshje kushtetuese, sipas përcaktimit të nenit 124 të saj.

Anëtare: Sonila Bejtja

VENDIM
Nr. 221, datë 9.11.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN TETOR 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 139/8 prot., datë 8.11.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin tetor 2021",

konstatoi se:

2 https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=2 (shih faqe 10, të raportit në gjuhën shqipe).

3 https://www.osce.org/files/f/documents/1/f/424457_0.pdf (shih faqe 1, paragrafi i parë).

- Shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" (FSHU sh.a.) janë 15.12.2020, sa në Bordin për ERE-s, 2.1.2021, dhe me Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021", është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, sa në Bordin për ERE-s, shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit, për vitin 2021", është 1.5 lekë/kWh.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin tetor 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Tetor 2021

Tetor 2021			Sipas aplikimit të FSHU sh.a.	Sipas Përllogaritjeve të ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	27.85	27.85
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84	0.84
Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante		Leke/kWh	28.69	28.69
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		**Leke/kWh**	**32.73**	**32.73**

- Bazuar në çdo element të formulës përllogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikim, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2021, të jetë 32.73 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 32.73 lekë/kWh, për muajin tetor 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 222, datë 9.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA DHE NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E MBETJEVE TË NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË MBETURINAT INDUSTRIALE, URBANE DHE RURALE, PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë

elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale"; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 139/7 prot., datë 5.11.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2021",

konstatoi se:

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE-së dhe WACC-së ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- VKM-ja nr. 27, datë 17.1.2018, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale", përcakton ndër të tjera se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, date 26.4.2017, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në e mësipërme, është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike).

- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 27, datë 17.1.2018, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi output si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar, ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mWh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

- MIE, me anë të shkresës me nr. 7789 prot., datë 29.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1042 prot., datë 2.11.2021, i drejtohet ERE-s për të vijuar procedurat për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi.

- ERE, me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga këto burime, do t'i drejtohet MIE-s për informacion, lidhur me subjektet për të cilat Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka lëshuar: 1. autorizimin paraprak; 2. miratimin përfundimtar, për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2021.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të

bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 223, datë 9.11.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 198, DATË 3.9.2018, MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" SHA (FTL SHA), NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 139/3 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Furnizuesi i Tregut të Lirë' sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018.

- Kushti i pikës 2, i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018, kërkon që: "2. Shoqëria 'Furnizuesi i Tregut të Lirë' sh.a. (FTL sh.a.), të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri 'Furnizuesi i Tregut të Lirë' (FTL sh.a.), nga struktura përkatëse.".

- Kushti i sipërcituar është miratuar në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", konkretisht në nenin 9, pika 2, germa "e", kërkohet: "Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse ..."

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., me shkresën nr. 2852/1 prot., datë 13.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 972/1 prot., datë 18.10.2021, ka bërë me dije ndër të tjera, se, në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. dhe në funksion të veprimtarisë së shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., është kryer transferimi i strukturës përkatëse nga punëdhënësi OSHEE sh.a. te punëdhënësi "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. Në vijim të këtij procesi shoqëria ka dokumentuar në ERE edhe organigramën e shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a.

- Me plotësimin e kushtit nga shoqëria, kjo e fundit rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 224, datë 9.11.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 216, DATË 11.10.2018, MBI TRANSFERIMIN E LICENCËS PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE SHA), ME NR. 250, SERIA P14SH, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 96, DATË 27.10.2014, TE SHOQËRIA "OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES" SHA (OSSH SHA), E VLEFSHME DERI MË DATË 27.10.2044

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/4 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, te shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri më datë 27.10.2044",

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. i është transferuar licenca e Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2044.

- Kushti i pikës 2, i vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 216/2018, kërkon që: "2. Shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.), të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.), nga struktura përkatëse.".

- Kushti i sipërcituar është miratuar në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e cila konkretisht, në nenin 9, pika 2, germa "e", kërkohet: "Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse ..."

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. me shkresën nr. 8754/2 prot., datë 20.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 973/1 prot., datë 22.10.2021, ka bërë me dije se me vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 31.12.2019, është miratuar në parim organigrama e shoqërisë OSSH sh.a. dhe me vendimin e Këshillit të Administrimit të saj nr. 20/1, datë 9.12.2020, është miratuar struktura organizative e shoqërisë OSSHE sh.a., sipas organigramës që ka përcjellë bashkëlidhur edhe në ERE me një numër prej 5837 punonjësish.

- Me plotësimin e kushtit nga shoqëria, kjo e fundit rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 225, datë 9.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "IRARBA ENERGJI" SHPK, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË *(UNITED BANK OF ALBANIA)* SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "a", dhe të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të pikës 1.3 dhe të pikës 1.6, të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; të nenit 4, germa "b", të neneve 6, 7 dhe 8, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 139/2 prot., datë 28.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë *(United Bank of Albania)* sh.a.",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1012 prot., datë 18.10.2021, shoqëria "Irarba Energji" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng të aseteve, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë *(United Bank of Albania sh.a.).*

- Shoqëria "Irarba Energji" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, të ndryshuar dhe është mbajtëse e licencës nr. 451, seria P19.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., në zbatim të nenit 7, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi ka mangësi, sa më poshtë vijon:

Neni 7, "Përbërja e kërkesës për transferim"

Pika 1. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- Germa "c" (Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve): plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për 2 vjetët e fundit: 2019 dhe 2020.

- Germa "d" (Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aseti, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre vjetëve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare): plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të bankës apo një përmbledhje të performancës/pozicionit financiar në treg të saj për 2 vjetët e fundit: 2019 dhe 2020.

- Germa "h" (Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve, që kërkohet të transferohen): plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë marrëveshjen paraprake të nënshkruar midis palëve, së bashku me listën e aseteve, si pjesë integrale e marrëveshjes.

- Germa "i" (Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij, për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit): plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë deklaratën e bankës, sipas formës së kërkuar (origjinale ose fotokopje e noterizuar).

- Pika 3 (Subjektet koncesionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen, për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e autoriteti shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve): pa plotësuar.

Referuar nenit 17.3, të kontratës së koncesionit të formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Shengjun", shoqëria duhet të depozitojë në ERE informimin e Autoritetit Kontraktor, në lidhje me transferimin e aseteve dhe, sipas rastit, miratimin përkatës të AK-së, nëse shoqëria ngarkohet me një detyrim të tillë.

- Pika 6 (Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre): pa plotësuar.

Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse dëshiron që pjesë të dokumentacionit të aplikimit të mos jenë të hapura për publikim, së bashku me arsyet përkatëse.

- Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë, rezulton se më datë 9.9.2021, është publikuar çështja CN-782802-09-21, për vendosjen e një mase sigurimi tatimor mbi pasurinë dhe të drejtat pasurore të shoqërisë. Sa më sipër, shoqëria duhet të informojë ERE-n mbi fazën në të cilën ndodhet ky proces (nëse është apeluar apo është në ndonjë proces gjyqësor), si dhe deri ku shtrihet kjo masë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (*United Banka of Albania sh.a.).*

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 226, datë 9.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ALBESP TRADING & CONSULTING" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/5 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'AlbEsp Trading & Consulting' sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1021 prot., datë 26.10.2021, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit

A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "e", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "c" dhe "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germat "a", "b" dhe "c", plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "c" (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB-ja), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentin e plotë në formën e kërkuar nga rregullorja (jo vetëm faqen e parë të dokumentit);

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për administratorin e shoqërisë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., si dhe për administratorin e saj;

dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të letrës mbështetëse të lëshuar nga "Credins Bank" me nr. 506 prot., datë 25.10.2021, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n nëse i ka plotësuar kriteret financiare të vendosura nga banka, në kuadër të mbështetjes financiare që kjo e fundit do t'i mundësojë për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën kërkon të licencohet;

dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa "e" (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi), plotësuar pjesërisht. Duke qenë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që në rast miratimi të licencimit të saj, t'i lihet si kusht depozitimi në ERE i sistemit IT, pas krijimit;

- germa "g" (dokumentacioni që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve), plotësuar pjesërisht. Në vijim të deklaratës së shoqërisë se nuk mund të krijohen zyrat përfaqësuese në këtë moment, pasi nevojitet shpërndarja gjeografike e klientëve, vlerësojmë që në rast miratimi të licencimit të saj, t'i lihet si kusht depozitimi në ERE i dokumentacionit që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve, pas krijimit të tyre;

- germa "i" (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët), plotësuar pjesërisht. Në vijim do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët të cilët do të furnizojë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 227, datë 9.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBESP TRADING & CONSULTING" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/6 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'AlbEsp Trading & Consulting' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1021 prot., datë 26.10.2021, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, germat: "a", "b" dhe "e", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat "c" dhe "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika "b" dhe "c", plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "c" (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB-ja), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentin e plotë në formën e kërkuar nga rregullorja (jo vetëm faqen e parë të dokumentit);

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për administratorin e shoqërisë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., si dhe për administratorin e saj;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për

shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të letrës mbështetëse të lëshuar nga "Credins Bank" me nr. 506 prot., datë 25.10.2021, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n nëse i ka plotësuar kriteret financiare të vendosura nga banka, në kuadër të mbështetjes financiare që kjo e fundit do t'i mundësojë për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën kërkon të licencohet;

dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germat "a" dhe "d" (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në gWh/sipas viteve), plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka paraqitur sasinë e parashikuar për t'u tregtuar për tre vite të licencës, por duhet të paraqesë në ERE edhe sasitë e parashikuara për dy vitet e tjera të veprimtarisë së licencuar pasi afati i një licence është 5 vjet, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 235, datë 26.11.2021

MBI MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË LICENCUARIT, NDRYSHIMIN E ORTAKUT/ AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT DHE VENDOSJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE TË ORTAKUT/AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT, SI MJETE PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT/EVE NDAJ TË TRETËVE"

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "g", si dhe nenit 51, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 13, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144/7 prot., datë 23.11.2021, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi miratimin e 'Rregullores për procedurat dhe afatet, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve"',

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 163, datë 12.7.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit".

- ERE, me njoftimin nr. 6/20 prot., datë 14.7.2021, ka publikuar njoftimin në median e shkruar mbi fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 844 prot., datë 22.7.2021, i është

drejtuar palëve të interesit: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, KESH sh.a., OST sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a., AAES, FIAA, AREA, ACERC, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, Albgaz sh.a., Albpetrol sh.a., Phoenix Petroleum sh.a., CGC sh.p.k., BALKGAZ sh.p.k., për marrje mendimi rreth ndryshimeve të propozuara.

- OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 844/1 prot., datë 29.7.2021, dhe ALBGAZ sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 844/4 prot., datë 27.8.2021, janë shprehur se nuk kanë komente apo sugjerime në lidhje me këtë draft.

- Shoqata AREA, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 844/2 prot., datë 9.8.2021, ka propozuar të saktësohet/sqarohet se çfarë nënkuptohet me ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë (neni 4), si dhe të bëhet saktësim i afatit/vlefshmërisë kohore që duhet të kenë dokumentet dhe deklaratat e lëshuara nga organet e tjera nga momenti i paraqitjes së kërkesës pranë ERE-s (neni 5, pika 4). Këto propozime janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në nenet e sipërcituara në rregullore.

- KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 844/3 prot., datë 12.8.2021, ka paraqitur në ERE sugjerimet/propozimet kryesisht me titullin e rregullores, saktësime dhe shtesa, në lidhje me vendosjen e kuotave/aksioneve si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve, propozon (germa "c", e nenit 2); saktësime të përkufizimeve (neni 4); formën e paraqitjes së dokumentacionit (pika 4, e nenit 5); dokumentacionin e kërkuar (neni 6 dhe 7); shtimin e një neni me dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve; vlefshmërinë e autorizimit dhe informimin e ERE-s mbi ecurinë e transferimit sipas autorizimit të dhënë (neni 9); përcaktime për shkeljet dhe kundërvajtjet administrative. Këto propozime/sugjerime janë marrë në konsideratë pjesërisht dhe janë reflektuar me përshtatjen e neneve të sipërcituara në rregullore.

- Pas përfundimit të afatit, nuk rezulton të jenë depozituar komente apo sugjerime nga palë të tjera të interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregulloren për procedurat dhe afatet, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, dhe brenda 45 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT DHE AFATET, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË LICENCUARIT, NDRYSHIMIN E ORTAKUT/AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT DHE VENDOSJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE TË ORTAKUT/AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT, SI MJETE PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT/EVE NDAJ TË TRETËVE

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 20, germa "g", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; "Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe kushtet e licencave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit, që paraqesin kërkesën për:

a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;

b) ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;

c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët paraqesin kërkesën, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore frazat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "Ligji për energjinë" është ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar;

b) "Ligji për gazin natyror" është ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar;

c) "Bordi i ERE-s" është organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar;

d) "ERE" është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar;

e) "Licencë" është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit të energjisë dhe ligjit të gazit natyror;

f) "I licencuar" është një person i cili gëzon të drejtën dhe është i pajisur me licencë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike apo të gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar;

g) "Procedurë" është tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi;

h) "Transferim kuotash/aksionesh" është çdo veprim me anë të të cilit krijohet një marrëdhënieje shitjeje, dhurimi, dhënieje me qira, transferimi, hipotekimi, barre ose çfarëdolloj disponimi tjetër i kuotave apo aksioneve të të licencuarit, kur nga ky transferim ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit;

i) "Ortaku/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit" është ortaku apo aksionari që zotëron përqindjen e nevojshme për të përcaktuar vendimmarrjen në shoqërinë e licencuar. Për çfarëdolloj transferimi kuotash apo aksionesh që ndryshon këtë përqindje është e nevojshme të merret autorizimi nga ERE.

PJESA E DYTË
PROCEDURAT E PARAQITJES SË NJË KËRKESE PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE

Neni 5
Paraqitja e kërkesës

1. Procedura për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, fillon me paraqitjen nga një i licencuar i kërkesës për një ose disa nga rastet e mëposhtme:

a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;

b) ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;

c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.

2. Kërkesa dhe informacioni bashkëlidhur kërkesës duhet të jenë nënshkruar nga personi ose personat që kanë kompetencën për përfaqësimin e të licencuarit.

3. I licencuari mund të caktojë dhe një përfaqësues ligjor për të paraqitur në ERE aplikimin, së bashku me dokumentacionin përkatës, dhe për të ndjekur procedurën deri në dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin, sipas kërkesës. Në këtë rast duhet të paraqitet në ERE prokura ose autorizimi i dhënë nga i licencuari për përfaqësimin e tij.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga i licencuari duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal, fotokopje e noterizuar, ose me vulë elektronike. Dokumentet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së kërkesës. I gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të depozitohet dhe në një kopje elektronike (CD ose USB).

5. Pjesët e dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim duhet të specifikohen në kërkesë, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre. Përndryshe konsiderohet se kërkuesi nuk e kërkon një kufizim të tillë.

Neni 6
Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor, duhet përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin/dokumentacionin si më poshtë:

a) emrin e plotë të të licencuarit;

b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e *email*-it;

c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e ndryshimit të statusit ligjor, duke përcaktuar dhe afatin e këtij ndryshimi;

d) ekstraktin historik të regjistrit tregtar të të licencuarit.

2. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 7

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:

a) emrin e plotë të të licencuarit;

b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e *email*-it;

c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit;

d) efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar;

e) një përshkrim të kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë (në rastin kur kontrollues i interesave të të licencuarit bëhet një person juridik/fizik);

f) informacion të detajuar mbi kontributin financiar që do të japë në ushtrimin e aktivitetit kandidati i propozuar për të kontrolluar interesat e të licencuarit;

g) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi ndaj të tretëve.

2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitohet në ERE dhe dokumentacioni si vijon:

a) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të të licencuarit, si dhe ekstraktet historike të regjistrit tregtar të të gjithë ortakëve/aksionarëve të të licencuarit, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;

b) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të kandidatit të propozuar për kontrollin e interesave të shoqërisë, në rastet kur ky është një person juridik/fizik. Në rastet kur kontrollues i interesave të të licencuarit do të bëhet një shoqëri e huaj, duhet të depozitohet ekstrakti me të dhënat tregtare përkatëse të regjistruara për këtë shoqëri, i përkthyer, i pajisur me vulë apostile dhe vërtetim përkthimi;

c) vendimi i organeve drejtuese të të licencuarit për kryerjen e transferimit të kuotave/aksioneve, transferim i cili ndryshon dhe ortakun/aksionarin që kontrollon interesat e të licencuarit, si dhe të organeve përkatëse drejtuese të ortakëve/aksionarëve të të licencuarit, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;

ç) vendimi i organeve drejtuese të shoqërisë tek e cila do të kryhet transferimi, ku të shprehet pranimi i këtij transferimi. Në rastet kur transferimi do të kryhet te një ortak individ, miratimi me shkrim i këtij të fundit për pranimin e transferimit. Në të dyja rastet duhet të shprehet dhe gatishmëria e kandidatit tek i cili do të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;

d) marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën, në rastet e barrësimit, hipotekimit etj., të kuotave/aksioneve;

e) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e autoritetit shtetëror;

f) vendimin gjyqësor të formës së prerë (në rast se ka), ku është vendosur ndryshimi i ortakut/aksionarit kryesor të të licencuarit.

3. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 8

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm, për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër)

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar, duhet të përfshijë në

kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:

a) emrin e plotë të të licencuarit;

b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e *email*-it;

c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e vendosjes së kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/ eve ndaj të tretëve;

d) një përshkrim të detyrimeve me të cilat ngarkohet i licencuari dhe pasojat në rast të mosekzekutimit të detyrimit sipas afateve dhe përcaktimeve të përshkruara në marrëveshjen paraprake;

e) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi tjetër ndaj të tretëve.

2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitohet në ERE dhe dokumentacioni si vijon:

a) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të të licencuarit;

b) vendimi i organeve drejtuese të të licencuarit për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/ eve ndaj të tretëve;

c) marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën;

d) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e autoritetit shtetëror;

e) vendimin gjyqësor të formës së prerë (në rast se ka), për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.

3. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 9
Shqyrtimi i aplikimit

1. Shqyrtimi i aplikimit për dhënien e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e tij.

2. Në çdo rast, por jo më vonë se 5 ditë pune nga paraqitja e kërkesës, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të plotësojë dokumentacionin e konstatuar të munguar nga aplikimi ose depozitimin e informacionit shtesë, brenda 10 ditëve pune nga marrja dijeni e mungesës së dokumentacionit/informacionit në aplikimin e tij.

3. Në rast se nuk plotëson dokumentacionin / informacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, kërkesa e të licencuarit për dhënien e autorizimit nga ERE quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuesit bashkë me aktet e tjera.

4. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk është dërguar sipas kërkesave të neneve 6, 7 apo 8, të kësaj rregulloreje, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni fillon nga dita e depozitimit të dokumentacionit/informacionit të plotë nga kërkuesi.

5. Pas analizës përfundimtare të dokumentacionit të depozituar, sipas përcaktimeve dhe afateve të kësaj rregulloreje, struktura përgjegjëse i paraqet Bordit një relacion, duke propozuar dhënien ose jo të autorizimit nga ERE, të shoqëruar me arsyetimet përkatëse, në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

6. Në rast refuzimi të kërkesës, ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme, brenda 7 ditëve pune nga marrja e vendimit.

7. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

8. Në rastet e dhënies së autorizimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e statusit ligjor apo transferimin e kuotave, i licencuari duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

Neni 10
Vendimmarrja e Bordit

1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje, Bordi i ERE-s do të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së

detyrimit/eve ndaj të tretëve, duke e bazuar vendimin e tij në:

a) plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur, në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion/ dokumentacion shtesë të ERE-s;

b) relacionin e hartuar nga personi/personat e ngarkuar, struktura përgjegjëse;

c) efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të aktivitetit të licencuar;

d) gatishmëria e kandidatit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;

e) gjendjen financiare të kandidatit të propozuar për transferim për të vazhduar me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

2. Bordi mund të japë dhe një vendim me kusht, rast pas rasti, në përputhje me specifikat e aplikimit, duke përcaktuar dhe një afat kohor për plotësimin e këtij kushti.

Neni 11
Njoftimi i vendimit

1. Në përfundim të procedurës për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/ aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, ERE do të njoftojë të licencuarin, sipas përcaktimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".

2. Për këtë vendimmarrje do të njoftohet dhe autoriteti shtetëror përgjegjës në rastin e dhënies së autorizimit nga ERE për një subjekt koncesionar apo që ka një autorizim nga autoriteti shtetëror përgjegjës.

3. Vendimi i ERE-s, i dhënë sipas kësaj rregulloreje, botohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

4. Kundër vendimit të Bordit të ERE-s, për miratimin apo refuzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, dhe brenda 45 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të gazit natyror.

Neni 12
E drejta për t'u informuar mbi përmbajtjen e regjistrit të autorizimeve të dhëna nga ERE

1. ERE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit regjistrin e autorizimeve, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Në këtë regjistër përfshihen të dhënat si më poshtë:

a) emri i të licencuarit;

b) NUIS-i (numri unik i identifikimit të subjektit);

c) numri dhe data e vendimit të Bordit të ERE-s për dhënien e autorizimit përkatës;

d) lloji i autorizimit të dhënë.

3. E drejta e aksesit në dosjen e dokumenteve shoqëruese u jepet personave me interes ligjor, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

4. Informacioni konfidencial do të trajtohet në përputhje me përcaktimet e "Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial".

PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13
Ndryshime të rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet nga Bordi i ERE-s dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 429, datë 11.11.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME ROSKOVEC SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 11.11.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Roskovec (UK Roskovec), me shkresën nr. prot. 169 prot., datë 1.10.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Roskovec në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe "Rregulloren e licencimit", si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Roskovec ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 17 238 banorë të Bashkisë Roskovec;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Vilson Naçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dega Metalurgji në vitin 1992;

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Roskovec, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Roskovec është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a. (me NUIS L63327402A), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Isa Hoxha;

b) Drejtues teknik – Vilson Naçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a. është Bashkia Roskovec.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 430, datë 11.11.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME CËRRIK SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 11.11.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a.'",

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik me shkresën nr. 312 prot., datë 8.10.2021, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Cërrik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe "Rregulloren e licencimit", si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Cërrik ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 29 720 banorë të Bashkisë Cërrik;

b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Jona Belshi, është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dega Shkenca në Inxhinieria e proceseve Kimike.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Cërrik, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme, për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Cërrik është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a. (me NUIS L63502206Q), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Eneo Taçja;

b) Drejtuese teknike – Jona Belshi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a. është Bashkia Cërrik.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Cërrik sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 431, datë 11.11.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 11.11.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shkodër (UK Shkodër), me shkresën nr. 1463 prot., datë 28.9.2021, dhe "Dokumentacion plotësues", me shkresën nr. 1477 prot., datë 29.9.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Shkodër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe "Rregulloren e licencimit", si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Shkodër deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 114 086 banorë të Bashkisë Shkodër, si dhe përpunimin e ujërave të ndotura në ITUN Shkodër (Shirokë, Velipojë) me një kapacitet për rreth 56 000 banorë dhe që funksionon për 42 000 banorë të qytetit të Shkodrës zonës së plazhit dhe fshatrat përreth tij;

b) Drejtuesit teknik, z. Lazer Pemaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitin 1989 dhe ka përvojë në profesion;

c) Drejtuese teknike, znj. Blerina Arrtunda, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Mjedis profili Trajtim Uji në vitin 2017.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në

konsideratë përmbushjen nga ana e UK Shkodër, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Shkodër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. (me NUIS J66902052A), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

c) Kategoria D – Për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) Drejtues ligjor – Mark Molla;

b) Drejtues teknik – Lazer Pemaj;

c) Drejtuese teknike – Blerina Arrtunda.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. është Bashkia Shkodër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 28.12.2021.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 432, datë 11.11.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME TEPELENË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 11.11.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë (UK Tepelenë), me shkresën nr. 187 prot., datë 7.7.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Tepelenë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM

nr. 958 dhe "Rregulloren e licencimit", si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Tepelenë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura për 11 919 banorë të Bashkisë Tepelenë;

b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Myftar Beqo ka mbaruar studimet universitare për Inxhinieri Ndërtimi, pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitin 1991.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tepelenë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tepelenë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. me (NUIS K29009502G), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Jetnor Haska;

b) Drejtues teknik – Myftar Beqo.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. është Bashkia Tepelenë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë